




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Pranuar - Prillogë Më/Dana 22-05-2024			
Nr. i organit Org. broj	Numri/Broj	Shtetë Prilog	Vlera Vendosje
01	060/01-		792



Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality of Viti/na

Në bazë të nenit 43, paragrafi 43.1 të Ligjit Nr. 03/L – 040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/15, Qershor, 2008) dhe të nenit 30, paragrafi 30.2 të Statutit të Komunës së Vitisë, Nr. 01-013/491, të datës 21.04.2011, dhe të nenit 5 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.02/2015 për mbajtjen e mbledhjeve të kuvendit të komunës, në nenin 6, pika 1 e Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/594, e datës 02.05.2014, kryesuesi i Kuvendit Komunal të Vitisë bënë këtë:

F T E S Ë

Ftoheni të merrni pjesë në mbledhjen e V të rregullt të Kuvendit të Komunës së Vitisë, që do të mbahet me datën **29.05.2024 (e Mërkurë)**, duke filluar në ora 10:00.

Mbledhja do të mbahet në Sallën e Kuvendit të Shtëpisë së Kulturës "Gursel e Bajram Sylejmani" në Viti. Për këtë seancë kryesuesi propozon këtë:

R e n d i t e

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e katërt e Kuvendit Komunal.
2. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit paraprak për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale (kijoskave) përmes ankandit publik.
3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për formimin e komisionit dhe zbatimin e procedurave për dhënien e pronës së palujshme të komunale (kijoskave) tek Shtëpia e Kultures Gursel e Bajram Sylejmani në shfrytëzim afatshkurt prej 15 vite.
4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shfuqizimin e vendimi për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale përmes shprehjës së Interesit në fshatin Budrikë të Komunës së Vitisë për vendosje të bizneseve në Parkun Industrial në Budrikë me numer protokollit 01-110/05-306 të datës 29.03.2024.
5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shfuqizimin e vendimit për Financimin e shujtave ditore për sherbyesit civil si dhe stafin teknik dhe mbështetës të Komunës së Vitisë janar-dhjetor 2024, vendimi me numer protokollit 01-110/05-308 të datës 29.03.2024.
6. Informatë Manifestimi Tradicional Kulturo-Sportiv "Flakadani i Karadakut 2024"
7. Informatë nga Drejtoria për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural për mbledhjet pranverore 2024.

Viti, më 22.05.2024

Kryesuesi i Kuvendit
Bekim Azizi



PIKA E PARË E RENDIT TE DITES



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

PROCESVERBAL

IMBLEDHJES SË KATËRTË TË RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË VITISË

Mbledhjen e ftoi dhe e kryesoi, z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë. Mbledhja është mbajtur më 29.04.2024 (e hënë) në Shtëpinë e Kulturës “Gursel dhe Bajram Sylejmani”, duke filluar me punë në ora 10 h. Në mbledhje morën pjesë kryesuesi i Kuvendit, z.Bekim Azizi, nënkryetari i Komunës, z.Hasan Aliu si dhe këshilltarët e Kuvendit: z.Ramadan Deliu, z.Basri Sylejmani, z.Sokol Shaqiri, znj.Valentina Mehmeti, z.Zejnepe Osmani, z.Sokol Hyseni, z.Illir Zuka, z.Ekrem Ymeri, z.Arbnora Hajredini, Marigona Avdiu,znj.Liridona Bislimi, z.Sejdi Emini, z.Nexhat Halili, z.Remzi Salihu, z.Durim Sylejmani, znj.Majlinda Shabani, znj.Lindita Demelezi z.Taulant Haxhiu, z.Musli Neziri, znj.Vilsona Maliqi-Salihu, z.Veton Ramadani, znj.Anisë Zejnullahu, z.Reshat Azizi, znj.Zyrafete Rama, ndërsa mungoi z.Ali Bajrami, z.Jakup Demiri. Në mbledhje morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive, zyrat e kryetarit, mediat elektronike, OSBE-ja dhe të tjerë.

Pasi u konstatua se prezent janë 25 anëtarë të KK-së, kryesuesi i Kuvendit e shpalli të hapur mbledhjen.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Mirëdita dhe mirë se keni ardhur në seancën e katërtë të rregullt të Kuvendit Komunal të Vitisë! Të nderuar të pranishëm, media, qytetarë të Komunës së Vitisë, përfaqësues të OSBE-së, mirë se keni ardhur në mbledhjen e katër për këtë vit të Kuvendit. Gjatë kësaj periudhe u kthye i kundërligjshëm vendimi për pagesën e shujtave. Pasi që ka ardhur me vonesë, besoj që në seancën e radhës do të diskutojmë për këtë. Materialin e keni marrë me kohë, korumi është i mjaftueshëm, para se të hymë në rend dite vazhdojmë me pyetje, përgjigje, duke ju kërkuar që të ju përmbahemi kohës.

znj.Majlinda Shabani: Përshendetje të nderuar të pranishëm! Sot deklarimi im jashtë rendit të ditës. Dua ta potencoj tek dy rastet e fundit të femicidit, që natyrisht na kanë tronditur gjithësecilin. E dimë që femicidi është dëshmi rrënjëqethëse që shpërfaq pabarazinë e rrënjësuar si dhe dhunën me të cilën përballen gratë. Është një rrëfim tragjik i jeteve të shkurtuara brutalisht vetëm për shkak të gjinisë, humbja e jeteve të grave nga duart e burrave është një njollë në ndërgjegjen tonë kolektive, prandaj edhe sot këtu para Kuvendit Komunal ripotencoj se, është nevojë urgjente që të forcohet zbatimi i ligjit dhe kryesit e krimeve të tilla të përballen me dënime më të ashpra të parapara me ligj. Krahas angazhimit nga niveli qendror janë rreth 40 nivele të obligimeve të politikave lokale që duhet të adresohen nga komunat, ashtu që të kontribuohet përmbajtësisht në parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje dhe ajo me bazë gjinore, obligime këto të dalin nga Strategjia kombëtare për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje 2022/2026. Andaj dhe komuna jonë duhet të ketë parasysh dhe me urgjencë duhet të vepronte në këto obligime, siq janë: të mbeshteten për pavarësim financiar viktimat e dhunës në familje, duke mbuluar pagesën për qera, duke mbuluar shpenzimet mujore për të mbijetuarat, subvencionimi i pagesave për kopshtet të fëmijëve të viktimave të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave, të pajisen me detektorë të sigurisë të gjitha strehimoret dhe qendrat për punë sociale nga komunat, të shtohen kapacitetet njerëzore profesionale në qendren për punë sociale. Bazuar në analizen që është bërë nga Ministria e Drejtësisë në të gjithë komunat, shtrirja e qasjes shumë sektoriale të kordinuar të trajtimit të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave në mbarë Kosovën përmes themelimit të mekanizmave koordinues në komunat ku mungojnë, informimi i viktimave të dhunës në familje, dhunës ndaj grave në ndihmë, përfshirë ndihmën juridike falas për persona të ekspozuar ndaj dhunës në një gjuhë që ata/ato e kuptojnë, mbeshtetja e strehimoreve me financim të vazhdueshëm për të ofruar siguri dhe mirëqenie për vajzat dhe gratë. Veprimi duhet të jetë i përbashkët dhe ndërinstucional në këtë drejtim,

andaj unë uroj që edhe kryetari i Komunës sonë, mirëpo edhe drejtorja përkthënë të reflektoj mbi këto politika lokale në mënyrë që me i zbatu këto obligime që janë dalë nga kjo strategji. Faleminderit!

z.Illir Zuka: Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Edhe unë bashkëndjej dhimbjen në emer tim dhe të grupit për rastet e fundit që kanë ndodhë, sidomos rasti më i dhimbshëm është rasti në Ferizaj që ndodhi, d.m.th është dashur të jetë vendi më i sigurt e dulë vendi më i pasigurt që humbi jetën një femer e re, kështu që bashkëndjej dhimbjen me gjithë tjerët. Në mbledhjen e KPF-së i kam bërë 2 pyetje, besoj që nënkryetari më njofton për ato dhe ju njoftoj që shkolla në Pozheran ka fillu të punohet. Uroj që me 1 shtator të perfundojnë punimet. Kam edhe një kërkesë tjetër. Ne e dimë që në projekte është e shtime edhe një urë që lidhë te “Jozava”, që shumë toka po mbesin pa punu. Besoj që fillojnë procedurat dhe përfundon ajo urë, se është një ndihmes e madhe për bujqit, për pjesën e Pozheranit.

z.Nexhat Halili: Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Pyetja e parë ka të bëjë me rrugën Sllatinë-Viti. Rruga ka filluar të implementohet nga viti 2020. Së pari është lidhur kontrata për zhavorr pastaj është lidhur kontrata e dytë e cila është anuluar më vonë. Është lidhur kontrata tjetër e cila është faza e dytë, asfaltimi i kësaj rruge. Deri tash ka kaluar 1 vitë që është shtruar kjo rrugë me asfalt. Unë para 3-4 dite kalova në atë rrugë, pash kompanit duke intervenu për eliminimin e të metave. Eliminimi i të metave ishte aq i madh, sa që mua më ka ardhur befasi kur e kam parë duke punu atë kompani. Pyetja ime është kur do të përfundojë kjo rrugë dhe kur bëhet pranimi teknik i kësaj rruge. Pyetja dytë ka të bëjë me rregullimin e trotuareve në Komunën e Vitisë. Implementimi i disa projekteve rreth rregullimit të trotuareve ka fillu diku 2-3 më herët, mirëpo këto projekte janë ende në fazën fillestare, duke përfshirë trotuarin i cili lidhë Trestenikun, Sodovinën dhe Sllatinën. Trotuari i cili lidhë Sodovinën e Jerlive me Sodovinën e Muhaxhereve si dhe trotuare tjera. Pyetja ime është: a ka ndonjë plan dinamik se kur do të përfundojnë këto trotuare? Sepse qytetarët e këtyre lokaliteteve shpesh pyesin, pse ka ardhur deri tek kjo fazë e nuk po vazhdojnë punët dhe nuk po përfundojnë. Kam dhe një pyetje rreth ndriçimit publik. Shumë lokalitete janë pa ndriçim publik. A ka ndonjë plan edhe për këtë rreth ndriçimit publik në Komunën e Vitisë?

znj.Zyrafete Rama: Përshendetje për të gjithë të pranishmit! I nderuar nënkryetar, rruga përrreth lumit “Morava”, e cila ishte e planifikuar të rregullohet nga grandit performances ka mbetur e dëmtuar tash e 6 muaj dhe është duke u rënduar jashtëzakonisht shumë qarkullimin rrugorë, rrugë e cila është arterie kryesore për qendrën e Vitisë. Pse është kjo vonesë dhe a pritët të rifillojnë punimet në këtë punë?

z.Basri Sylejmani: Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Unë kisha me u lidhë me atë gocën e cila foli për dhunën në familje. Unë e përkrahi atë, por në qoftë se ka mundësi shkollat që po mbesin pa nxënës me të ndonjë meremetim dhe me lanë ndonjë rezervë për kësi raste dhunë në familje, që janë me i rregullu me banjo me krejt, që në qoftë se ka nevojë najkun jo me pritë ne me qu nëpër restaurante apo najkun, po me qu drejtë e në strehimore, aty si strehimore. Po e za ato shkollat mbesin e aty ne me intervenu me të lokacionin në qoftë se ka mundësi në bazë të ligjit. Unë nuk jam tu folë pa ligj.

z.Taulant Haxhiu: Përshendetje për të gjithë të pranishmit, unë e kam pyetjen e parë për fshatin i cili është hambari i bujqësis në komunes së Vitis fshati Skifteraj, një qeshme një 5 minuta e keni pas leshu në kohë fushate dhe është fshatë që më së shumti ka nevoj por ujësjelles dhe nuk ka funksionalizim të ujësjellsit, ka ankesa tek banoret e fshatit Skifteraj përshkak se ata e punoja bujqësin dhe kanë nevoj shumë për ujësjelles, kam dhe një pyetje tek rruga Muhamet Muharremi ku është trotuari prej ruges Pozheranit e deri tek Shell petrolli, mua mu kanë anku banoret por unë e kam parë ai trotuari ish qaq i ngusht që një njeri mi pas 110 kg ish problem me dalë në rrugë, e keni të trotuarin veq për një njeri aty ka ankesa të qytetareve të cilet hecin me femij trotuari është shumë i ngusht prej ruges Pozherani deri tek pompa e Alidemve ruga saktësisht Muhamet Muharremi, është domtu krejt trotuari është mirë kur ti rregullojm trotuaret me i kqyr kaniher a i ka prish shiu a jo, degjova që po dojnë me indru keto kubzat te keto kafiterit te ruga shtepia e kultures në qfotë se ka ndonjë projekt dhe don me u të tash dhe me mbet si kjo rruga me kalderm aty duhet me ditë që ka kafiteri dhe restaurante, kafiterit dhe restaurantet në atë pjes që janë që 2 është kolosi jan tjerat, kafiterit në Viti e presin korrikun dhe gushtin ato janar, shkurtin, marsin e permbyllin me minus, në qoft se ne ja bllokojm rrugen atyre që ata mos me mujt me

punu beso që 25 vetë ki mi qu te shpia dhe ki mi mbyll ato kafiteri, fugia e tyre për ata me mbajt veten për 1 vitë është korriku, gushti në goftë se kemi ndonjë projekt me bë është mir ta bajm pas sezonës.

z.Musli Neziri: Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Pyetjen e parë e kam për drejtorin e bujqësisë. Disa ankesa na kanë ardh tek regjistrimi i kafshëve. Nga blektorët tanë ka pas problem me i regjistru kafshët e tyre. Ku qëndron problemi, pse është blloku ky proces? Sepse ata thanë që, për shkak numrit jo regjistrimit që e kemi nuk po mujmë t'i regjistrojmë saktë. D.m.th a është problemi prej drejtorisë që duhet kryhet apo prej Ministrisë së Bujqësisë. Pyetjen tjetër e kam tek Drejtoria e Shërbimeve Publike, për rreth menaxhimit të mbeturinave përrreth, në qytetin e Vitisë sidomos. Dje isha në një pamje jo të mirë sa i përket mbeturinave në qytetin e Vitisë dhe po kërkoj që të kihet kujdes ose të rritet numri i kontinjerëve aty, sidomos ku ka banorë më shumë që frekuentojnë ose të gjendet një modalitet. P.sh.: siç janë kontinjer nëntokësor. Dje isha dëshmitar i asaj që nuk i kanë nxanë mbeturinat kontinjerët që kanë qenë, kanë qenë të stërmbushur dhe është shpërmda, që pamja ishte vërtetë shumë e keqe, prandaj kërkoj ose të bëhet ndonjë zgjidhje, kontinjer nëntokësor ose format që ju mendoni, format janë më të mira ose atë pamje vërtet nuk ja dëshiroj qytetit të Vitisë. Të shihet, ishte vikend, ka mujtë të ketë vizitor nga qytete tjera. Në saje të kësaj duhet një vetëdijësim i gjithmbarshëm. Ne e dimë atë, por ishte jo mirë.

z.Sejdi Emini: Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Unë sot do ta ngris një çështje e cila ka të bëjë me lumin morava që kemi mes qytetit. Është një bukuri natyrore që ndoshta shumë qytete do ta kishin për lakmi dhe investojnë në mënyrë artificiale për me i kriju mes qytetit gjatë stinës së Verës lumi pothuajse shumë pak ka rrjedhja të ujit. Qysh ekziston mundësia që me i bë disa barriera ujore me një matje pa paraqitë rrezik 50 cm që me pas ujë të vazhdushëm gjatë stinës së Verës si lloj ujvare, sepse sigurisht që edhe pastertia, freskia, natyra do të ishte më e mirë. Besoj që nëse kish mujtë me u bë kjo do të ja shtojke bukurinë qytetit të Vitisë. Edhe shumë më mirë është me pas ujë në mes qytetit. E dyta ka të bëjë me disa drunjë që po mbjellen gjatë kësaj stine. Kemi rastin në Goshicë tek shkolla. Janë mbjell 35 drunj. Prej këtyre veq 5 kanë nxan, 30 kanë dështu. Personalisht me kompaninë e cila i ka punu kam diskutu, kanë thanë që përgjigjen, mirëpo nëse nuk përgjigjet është para ose taksë e qytetarëve të komunës sonë diku 40/50 euro është copa. Dami është shumë i madh, që duhet me pas parasysh këtë çështje, sepse ata rriten një ditë për me u rritë me pas gjelbrim, fushat e futbollit të cilat janë me beton. Ato vazhdimisht janë tu paraqit rrezik për nxënësit ne shkolla dhe fëmijët e vegjël, konkretisht tek ne atje për çdo vitë e then ndonjë nxënës dorën apo këmbën. Ndoshta kemi me u detyru mos me i lanë me bë aktivitete fizike në botën, sepse mbi të gjitha është shëndeti i fëmijëve dhe qëllimi është ai. Kisha kërku që ajo fushë dhe kudo qofshin që janë me asfalt, beton të bëhen me gumë.

z.Reshat Azizi: Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Çështja e ujësjellësit në Stubëll. Dua ta di deri ku ka mbërri. Kemi pas bisedu për një trotuar të mundshëm për shtegar Stubëll-Letnicë. Tejtira. Ka qenë prezent nënkryetari me 15 gusht kur kemi bisedu me ministrin Liburn Aliu për zgjedhjen e mundshme të një rruge alternative për Letnicë. Shkaku i festës së gushtit, aty është e pamundur me kalu. Ai na ka premtu që do ta bëjë një zgjidhje. A ka bisedu me nënkryetarin a ka pas një qasje me të dhe deri ku ka mbërri çështja.

znj.Liridona Bislimi: Përshendetje për të gjithë të pranishmit! I nderuar nënkryetar, tu e pas parasysh faktin që tashmë jemi në stinën e pranverës. Po kërkoj prej juve me pas parasysh një shqetësim që kam ngritë dhe vitin e kaluar prej qytetarëve ka të bëjë me prerjen e barrojave nëpër trotuar, por edhe nëpër pjesët anësore të trotuareve, sidomos nëpër ato vende të viseve rurale, por edhe vendeve më afër qytetit, për shkak se edhe viteve të kaluara ata të cilet janë marrë me pjesën e bujqësisë në fshaitn Doboldeh, Buzovik, Lubishtë, Beguncë etj. Kanë pas shumë probleme me pjesën e rritjeve të drunjëve, por edhe te pjesa e trotaurit, kështu që kërkoj këtë vit ta keni parasysh këtë problematikë dhe të filloni më herët me dezinfektimin dhe prerjen e ketyre barrojave. Çështjen tjetër që dua ta diskutoj ka të bëjë me drejtorin e arsimit. E nderuara drejtoreshë, ne para pak muajsh kemi parë që keni fillu me bë renovimin e shkollës në fshatin Sodovinë të Qerkezëve. Në të njëjtën kohë kemi parë përmes mediave lokale, nacionale, ai renovimi që është bërë në formë jo të hijshme. Ne të themi ajo djegia e librave që është bërë, gjendje e cila ka qenë jo e hijshme. Po më intereson me ditë deri ku qëndron ai renovim i kësaj shkolle, për shkak se e dimë që nxënësat e asaj shkolle aktualisht janë bartur tek shkolla e fshatit Sllatinë.

Kjo normal që është e papërshtatshme edhe për prindërit, por edhe normalisht për nxënësit. Më intereson si opozitë me ditë deri ku keni vazhdu me këtë pjesë të renovimit.

z.Basri Aliu: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! U bë një pyetje për ndriçimin publik që nuk ka nëpër shumë fshata. Unë nuk pajtohem me këtë se, thuajse në secilin fshat ka ndriçim publik, por jo në atë masë se edhe nëpër lagje të shtrihet në të gjithë territorin aty ku ka banim. Tek regjistrimi i kafshëve, po ka pas vështirësi, por nuk ka qenë faji tek Drejtoria e Bujqësisë, por për shkak vonësës së Ministrisë së Bujqësisë, e cila nuk ju ka dhanë vathë që me qenë të evidentum, por u arritë një kompromis në këtë drejtim dhe ne i kemi regjistru. Faktikisht ata kanë apliku në mënyrë që kur të vendosen ata ta kenë mundësinë ata ta perfitojnë këtë subvencion. Për menaxhimin e mbeturinave realisht kemi telashe, kemi telashe dhe prej qytetarëve, sepse ata disa të dieleve që po thu, sigurisht kompania është në pushim dhe po na sjellin prej fshatrave, po vinë me kerre po mushin kontinjerin, sepse ata janë planifiku që ai kontinjer duhet i përfshi ata banorë që janë aty afer. Duhet me apelu që të regjistrohen qytetarët në menyre që të mos kemi telashe me mbeturina, edhe të hedhin, se shpesh po e përmendi këtu se nëpër fshatra këtu po mbahet pastertia. Por tani kemi fillu me ndot natyrën, që edhe kjo është një gjë e keqe, por duhet aty ku jemi të kontribuojmë në këtë drejtim që edhe natyrën mos ta ndotmi. Për lumin "Morava" e permendi, sigurisht që është e planifikume si ide ajo, kështu që edhe kreytari e ka këtë mendim, dhe ndërkohë besoj që edhe kjo punë do të realizohet. Ujësji në Stubëll. Ne kemi kontakt me kompaninë "Hidromorava" edhe me banorët, administratorin e fshatit Stubëll dhe kemi ardhë ne konkludim që, ata duhet të kyqen në mënyrë që uji të shkon deri në Stubëll, por për shkak të kyqjes së tyre është problemi që nuk kanë ujë nëpër shtëpia, ndërsa telash tjetër rreth saj nuk ka.

z.Basri Sylejmani: z.Drejtori, a keni tentu ju me i shti në regjistër që nuk pagujnë bërlllog, se aty është problemi që, ata e gjujnë bërlllogin. Ne në fshatin Sodovinë janë 110, a fshati Sodovinë i ka 240 shtëpi. P.sh.: gjysa fshatit bërlllogin e gjujnë nëpër kontinjere a gjysa tjetër e gjujn kudo. Për atë kemi bërlllog. Shkojnë gjujnë në Goshicë që e kan bërë deponi. Nashta nuk jeni edhe ju fajtor, por ne jemi fajtor që nuk i shtim në regjistër ata njerëz që nuk e paguajnë bërlllogin e ata na bëjnë neve deponi. Ne duhet me bë kush ka orë të rrymës, vetem ata që nuk kanë mundësi me pagu me i liru.

z.Sejdi Emimi: Mbi fshatin Goshicë është një natyrë e mirë dhe i kanë bërë disa deponi të egra, që me të vërtetë është urgjente dhe ja vlen Komuna ose kompania me ardhë me i hekë ato deponi të egra. Është e tmerrshme me ardh me i kyqyrë ose me marrë masa për ata që po i qesin, mirëpo njëhere pa i largu nuk bënë. Basria edhe ai e konfirmoj.

z.Illir Zuka: Jam prej atyre që kam kërku më së shumti të heken deponitë, sidomos po flas tani për vendbanimin që është më i madhi, për Pozheranin, tu e falenderu drejtorin e shërbimeve publike, ka ndërmarr, i kanë hekë, besoni apo jo me shku me shiku të njëjtin vend nuk dihet që u hekë. Unë prapë besoj që qëndron problemi diku tjetër. Nuk duhe të heket asnjëri. Unë shkoj e paguj veç taksen 1 euro. Unë nuk jam në sistem të mbeturinave, ku po i hudhë ti mbeturinat. Unë nuk di ku i hudhin ata, d.m.th Pozhernai është veç 60% e fshtit është në sistem të mbeturinave. Unë kërkoj prej drejtorit të shërbimeve publike një takim me "Ekohigjenes" dhe krejt çka janë ose ne të pagujnë krejt ose asnjë, se sa dush unë mendohem me majt pastër kur ai afër meje nuk është. Ai ka me hudhë dikun. Edhe është nje problem që njëmend duhet me ngritë. Unë pajtohem me Basrin, d.m.th një shqetësim shumë i drejt. Drejtori i shërbimeve ka hargju një buxhet të madh kur i ka hekë 3 betoni të mëdha që kanë qenë në Pozharan. Tash me shku me i kyqyrë është e njëjta gjendje, veç 2 javë ka qëndru e pastër.

z.Musli Neziri: Drejtor, faleminderit për përgjigjet. Tek pyetja parë që bëra për regjistrimin e kafshëve thatë që ministria është vonu, mirëpo a mos do të ketë masa ndëshkuse, sepse ka ndodhë që blegorët për shkak masat këtyre që janë vonu kanë pas masa ndëshkuse, kanë hy në listë të zezë të subvencioneve. P.sh.: për që s'kanë ardh ata me i regjistru me kohë, ata vetë ministria i kanë shti në listë të zezë. Drejtori Naim Pira veç ka qenë i informum rreth ketyre problemve që kanë ndodh, por faji nuk ka qenë tek Drejtoria e Bujqësisë veç mos të ndëshkohen blegorët tanë, ndërsa tek pjesa e mbeturinave pajtoj me të gjithë parafolësit, sepse gjithë kemi çka flasim në këtë pjesë. Unë mendoj që, sidomos tek ndërtimet e larta që janë më kolektive, a bënë me u rritë numri i kontinjerëve ose tek bizneset. P.sh.: e ke pas dje tek rrethi te xhamia, ka qenë kontinjeri i stergarkuar. Me pas

më shumë kontiniera ose kontinierë nëntokësor kish kry punë. Ideja është te menaxhimi më i mirë, sepse edhe qytetari kur nuk ka ku e qetë e hudhë aty.

z.Nexhat Halili: Drejtor, unë nuk aludova vetëm në lagje, por e ke në Sodovinë të Muhaxherëve që e ke pa ndriçim. Ka rrugë të tjera edhe tek fshati im që lidhen drejtpërdrejt me Komogllavën dhe aty nuk ka ndriçim. Nuk aludova vetëm në lagje. Nëpër lagje është e vertet që nuk ka, por ka edhe rrugë kryesore që nuk ka ndriçim.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Çështja tek menaxhimi i mbeturinave është çështja tek kapacitetet e "Ekohigjenës", sepse edhe "Ekohigjiëna" nuk e ka zgjeru, se shumë lagje kanë kërkesë, mirëpo për shkak rrugëve të ngushta, për shkak disa mundësive që nuk mujnë me shku mi marrë, kanë deklaruar që nuk i kanë shti ato familje me ngarkesë. Ka shumë familje që nuk shkon me marrë me ja kry shërbimet, nuk mundesh me shti në menaxhim. Unë mendoj që kompania në bashkëpunim me Komunën duhet me gjetë zgjidhje që me i shti krejt në menaxhim, çdo familje dhe me shku çdo kujë me ja marrë mbeturinat. E dyta, është ajo që tha drejtori, i mushin kerret të dielen, veç vijnë i gjujnë aty dhe aty e bajnë tmerr. D.m.th ndoshta edhe inspeksioni ka mundësi.

z.Basri Aliu, drejtori: Unë pajtohem gjithsesi me juve që, çështja është një formë alarmante, por ne të gjithë që jemi këtu po flasim rreth atyre, por nuk po veprojmë këtu, është problemi aty ku jeni në mesin e juve. Ju jeni vetë që mundeni t'i bëni këto zgjidhje, sepse drejtë ligjore nuk kemi ne që t'i regjistrojmë ata që nuk dojnë. D.m.th ata vetë duhet me shku mu lajmru atje, por duke bërë ju presion në çdo vend, çdo fshatë, atëhere kishte me ardh tek një rezultat më i mirë që, edhe ata të inkuadrohen ose të lajmrohet ata që hudhen mbeturina, por para syve tonë hudhin mbeturina dhe në shuajmë, ndërsa vijmë këtu dhe bisedojmë rreth tyre. Sejdë, për atje ndoshta është e vërtet për atë që thua, por ju si qytetarë të atyhit, në qoftë se nuk e bëni si qytetarë ju të Goshicës të tjerët bënë mi lajmru. Çdo qytetar e ka për detyrë me i njoftu institucionet. Tek bujqësia, edhe një here po thamë, unë kam kontakt me Ministrinë e Bujqësisë, saqë kam kontakt edhe me zv.ministrin, arsyen pse me ju dhanë një përgjigje dhe fermerëve. Ai më ka drejtu diku tjetër, që unë kisha kontakt. Ata janë vanu me procedura për shpalljen e tenderimit, kështu që ne kemi marrë si udhëzim që t'i regjistrojmë, ne këtu t'i paraqesim dokumentacionin dhe masanej kur të bëhet me veteriner që e fitojnë këtë tenderin, do të filloj implementimi i tyre. Këto fjalë janë, çka ndodhë më vonë nuk mund të jap përgjigje.

znj.Arta Ajeti, drejtoreshë: Përshendetje për të gjithë të pranishmit! E nderuara këshilltare Liridona, sa i përket pyetjes tënde rreth shkollës së Sodovinës së Qerkezëve, që është paralele e ndarë, po në takim dhe pajtim me prindërit, kërkesa e tyre ka qenë që, shkolla e tyre të renovohet sa më shpejtë për shkak mykut dhe vllages, kështu që, pajtim me prindërit, nxënësit i kemi transferu në shkollën amë në Sllatinë dhe për një kohë shumë të shkurtë nxënësit janë kthyer. D.m.th vijnë mësimin në Sodovinë të Qerkezëve, ndërsa demolimi sa i përket është shkolla e vjeter që është në fshat, në Sodovinë të Qerkezëve aty, e cila është jofunksionale, kështu që ne jemi në rregull.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës: Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Një shqetësim të cilën e ngriti këshilltarja Majlinda, që ai shqetësim besoj i ka prek të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, me të vertet për një kohë shumë të shkurt kanë humbur jetën 2 nëna, 2 femra, por këtë shkresën të cilën e lexoj këtu, neve na ka dërgu Ministria e Drejtësisë, edhe pse realisht aty dalin shumë detyra në adresë të Komunës, obligime të cilat individualisht me qenë në atë takim në shumë çështje e kisha kundërshtu, se kur i jepet dikujt detyra, duhet me i ofru kushte. Kur themë kushte, duhesh me i ofru fond, se shumë letë është me caktu, por megjithatë një prej saj jeni edhe ju dëshmitar të asaj që, një marrëveshje e kryetarit me OSBE-në dhe strehimoren në Gjilan, të cilën kryetari i Komunës e nënshkruan një marrëveshje prej 5 mijë euro. Unë e shti në Kuvend, ata e kthenë të paligjshme, edhe këtë duhet me i tregu ministreshes që, duhesh me pas kujdes se të ka shkru vendimi kujna pi jepet për çka po i jepet është konkretisht për këto raste, por megjithatë ne nuk do i kqyrim, do të ecim vertikalisht formën, menyrën dhe do ta zbatojmë atë marrëveshje për shkak se me vite të tëra e kemi zbatu e kemi ndihmu dhe do ta ndihmojmë në kuadër të kushteve. Unë besoj që do të bëjmë përpjekje maksimale që ta zbatojmë strategjinë Majlind, për shkak se besoj është jo vetem obligim, sot është prek dikush tjetër nuk do të thotë që neser nuk do të preket një anëtar i familjes sime, që unë i konisderoj të gjithë anëtar të familjes, dhe në këtë rastë duhe të jemi me një zë, por aty pse e ngrita këtë çështje, aty ku ke mundësi thuaja edhe këto se jam për me punu, jam për me luftu atë dukuri negative, por me na kriju pak kushte më shumë. A e din pse po e themë se Vitia e ka

mungesën e pares në Prishtinë, nuk është problematik se teprojnë, por sidomos në komuna të mesme si Vitia e kanë problem këtë çështje. Ilir, për ato pyetje që paske shtrru, i paske informacione dhe po më vjenë mirë që shkolla në Pozheran ishalla vepron me ritëm të shpejtë dhe përfundon për shkak që me të vërtet ka qenë problem shumë i madhë. Unë besoj Nexhat, në momentin e krijimit të kushteve formohet dhe komisioni dhe bëhet pranimi teknik në rast se e meriton ajo rrugë meu pranu. Besoj që shkon në kuadër të kontratës që ka, por edhe obligimeve ligjore që është lidhë ajo kontratë. Po më vjenë mirë që ka dalë me sanu të metat, për shkak se gjithçka ka garancionin e vetë. Besoj edhe ajo rrugë e ka dhe në kuadër të saj janë dalë. Çështja e trotuareve. Ti e dinë kanë qenë të përfshirë vitin e kalum. Nuk ka mujtë me i kry, ka qenë një ndërpreje e kontratës, një prerje e punëve tash mund disa fshtara me ra pikërisht aty, se në disa lokalitete i ka kry disa jo. Më detajisht nuk e di, veç e di që në këtë çështje është ndërpre kontrata, nuk i ka kry. Zyrafete, jam marrë unë konkretisht me këtë rastin e rrugës me kompani. Aty paska qenë një keqkuptim ndoshta, inxhinirat qysh më kanë tregu. Fillimisht projektin të cilit ja kanë dhanë kompanisë, më vonë ka dalë se nuk guxon në atë formë, por duhet me shtrru ibercuk, etj, etj. Dhe pas shkresës të cilës ju ka drejtu kompania me gjithë Zyren Projektuese ka ardh mendimi i ekspertëve se, fillimisht projekti ka qenë mirë dhe u dashtë të zbatohet në atë formë për shkak se mjetet të cilat janë mbi 3.5 ton nuk po guxojkan mu shtrru gjithmonë. Po flasë në bazë të ekspertëve që na kanë dërgu shkresen me ibercuk, por duhet të jetë me zhavorr tu i pas anësoret për anash për shkak se do të kalojnë edhe pesha më të rënda. Unë besoj se së shpejti do të ja nisë veç ka fillu me i pru kubazat apo kalldermen. Gjithmonë unë kam bërë presion që para 14 qershorit për shkak ditës së çlirimit me qenë e përfundume. Nuk u zotu ai në këtë drejtim, presionin jam tu e bë në atë drejtim. Sot është e hane, ai sot veç duhet me ja nisë me fillu qysh kemi bisedu të premtën. Çështja Basria e shtoj nuk ka mundesi të behet nuk qenka këtu ajo që e lypi përshkak se formimi i një strehimores me formu një strehimore në Viti po kerkon kuardo kerkon objekt janë krejt shpenzime të cilat nuk ka mundesi dhe keto jan nivelit regjional. Ujësjellsi në fshatin Skifteraj, shiritin nuk kemi pas nevojë me pre, por qeshmen e kemi lëshu. Ajo ka qenë një kontratë të cilën e ka pas kompania “Teuta” dhe në paramasat dhe parallogaritë të cilat i ka pas i ka kry atë defekt, ka arritë me sanu dhe kanë dalë probleme tjera, të cilat projekte të cilin e ka kontraktu. Ai nuk ka mujtë me funksionalizu kur është kërku, për më tepër ai e ka kontestu këtë çështje dhe lënda është në gjykatë. Krejt po të themë sipas informacioneve të “Hidromoravës”. Për trotuarin e ngusht nuk po e di, por do të dalë në vend të ngjarjes ta shikoj pse është i ngusht, sepse trotuaret prej pasqyrës deri në Drobesh janë bukur të gjëra, por nuke di si qenka çështja aty, e di se kanë pas telashe rreht nja 2 pronarëve të shtëpive që nuk i kanë kthy në vendin e mëparshëm. Do kocka aty që kam intervenu te kompania me kthy në bazë të kontratës. Çështja e rregullimit të sheshit është zbatueshmëri e planit të mobilitetit. Bashkëngjitja e këtij sheshi që kemi pak më larg dhe besoj që ne nuk jemi me pengu askënd, por ata biznese në rast se tu kanë drejtu me ankesa, ata biznese na kanë bë panderpre neve trysni për me rregullu. Tash a duhet me zgjedh sezonën, kontrata është lidhë, një takim kam pas me kioskat që janë aty, që mu ka zotu që brenda 3 jave ka me rregullu, ndërsa për këtë pjesën nuk kam bisedu. Besoj që kemi me gjetë atë modulën që mos me pengu. Musli, për çështjen është diku gati 2 vite që nuk ka martikulim në Komunën e Vitisë, jo vetem këtu, por në krejt Republikën e Kosovës jam interesu edhe unë personalisht, këtë çështje e ka AVUK-i, nuk besoj për këtë që do të sanksionohen. Tash a u dashtë me i zanë kjo fermerët në këtë kohë, unë besoj që ata u dashtë me qenë edhe Ministria e Bujqësisë më vegjilent, pa nderpre i kam bë presion të madh drejtorit, kam bërë presion nivel ministror, se me të vërtet blektorët adresë e kanë Komunen dhe nuk duhe të ju hupet vullneti dhe të mos e gëzojnë një drejtë e cila me ligj ju takon. A është një neglizhencë dilemë nuk ka, po se unë vetë i takoj një pjese fermerizmit se e ka 2 vite që janë pa matrikul. Gjithë ato të cilet janë pa matrikul nuk mujnë me apliku. Tash e paskan bë me paraqit numrin dhe ndërkohë mos po bëjnë zgjidhjen. Në rast se pësojnë për këtë, me të vërtet do të ishte një padrejtësi e madhe që do të ju bëhet. Sejd, më vjen mirë që e ngrite, se unë e di që këtë shqëtsim kryetari vazhdimisht bënë presion që me të vërtet mos me i lëshu këta mbjellsit e drunjeve dekorativ që janë në Komunën e Vitisë dhe ta përfillin garancionin që e kanë me të vërtet, kjo prej 35, vetëm 5 me kry efektivitetin e vetë në bazë të kontratës, besoj se duhet me u kthy mi mbjell të tjera. Te fushat e betonit ti e dinë që është në program të kryetarit që ka fillu prej lokaliteteve të mëdha dhe po shkon, por kapacitetet buxhetore nuk e kan leju krejt për një here të kryhet. Unë besoj që do t’i vie radha dhe Goshicës dhe të gjitha shkollave. Për trotuarin Stubell-Letnicë, Reshat, nuk e di çka

muj me të thanë, nuk jam boll në dijeni, e di që ndoshta do t'i kish shërby ndoshta do ta kish funksionalizu edhe datën e famshme 15, të cilet është zoja e madhe në Letnicë, ndërsa për rrugë alternative veç ka kalu projekti. Unë besoj që veç është tenderu dhe duhet me prit e ka mbajt fjalën ai, nuk diskutohet. Unë kam qenë nënshkrues i kontratës, marrëveshjes, ajo punë besoj që do të kryhet. Liridonë, drejtori nuk e di a më iku apo nuk u përgjigj, sepse unë i shkruaj të gjitha pyetjet, besoj që kanë kontratë dhe do t'i qëndrojnë. Drejtor, e ka pas ngrit Sejda një që kam kalu dhe e kam parë si rast për rrugën në Smirë – Goshicë. Disa therra janë rritë aq shumë sa që nuk po kalojshin dy kerre. Nuk e di si e ke atë çështje.

z.Basri Aliu, drejtori: Nënkyetar, unë kam qenë edhe vetë në vend të ngjarjes, por të gjitha ato janë pronat private. D.m.th ne nuk kemi të drejtë në pronë private me shku me intervenu, me rregullu. Kam kalu e kam parë atë rrugë.

z.Hasan Aliu, nënkyetar i Komunës: Duhet ta trajtojmë problemin dhe ta gjejmë formën me zgjidh.

z.Sejdi Emini: Te kjo puna rreth strehimores u diskutu mjaft shumë. Ne e dimë që gjykata ka me dalë poshtë atje dhe në vend gjykatës ka me dal policia. Unë mendoj që është si mundësi e mirë me shqyrtu që, stacioni i policisë me bë një renovim gjeneral dhe këto viktimat me u stacionu aty përkohësisht edhe afër policisë janë në siguri, dhe këtu është mes qendrës së qytetit, do të ishte vendi më adekuat për këta personat të cilët folem deri tash.

z.Hasan Aliu, nënkyetar i Komunës: Sejdë, nuk është problemi objektit, problem është se aty duhet me pas psikolog, pedagog, ka që shkojnë nanë me 5 fëmijë, duhet me pas shërbim, me ja qu fëmijët në shkollë që kemi pas rastë të Vitisë, prandaj është ajo qendra në Gjilan që ne kemi marrëveshjen atje i qojmë, këtu në stacion mundet me nejt për 1 orë derisa të pyetet, atje a ka vend. Sa i përket në Viti për 1 orë 2 nuk kemi pas telashe derisa kemi fillu me bashkfinancu më nuk kemi pas telashe të natyrës së tillë. Gjithëherë i kanë marrë ato të cilat kanë qenë dhunë në familje, nuk kemi pas telashe.

z.Ilir Zuka: Unë po besoj që kërkesa e Majlindës masnej që u nderlidha me të, ke diçka tjetër me atë për banim me atë për Basrien, se ajo as nuk duhet me thanë që me u kthy shkolla çerdhe, ajo nuk është asgjë. Unë po mendoj që drejtoresha qenka këtu me mbajtë një takim me policinë, të paktën takimet kur të bëhen, se e dimë që kanë takime prind që jan nda, që e qojnë fëmijën apo diçka të jetë të paktën sigurimi për gjininë femërore aty, se ne e dimë vendin më të sigurt. U vra një femër në Ferizaj, dhe unë besoj që Majlinda e nisi. Për këtë tash dul krejt tjetër, ja me siguru banim, d.m.th ti sadush siguroj banim kur po takohet aty po e vret në vendin më të sigurt ku ka ndodh rasti. Po besoj që këtu drejtoresha duhet me bë një takim me policinë.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Nëse ju kujtohet drejtoresha, ka kërku qe thotë, ne nuk kemi as sigurim për tek çështja e trajtimit.

z.Musli Neziri: Nënkyetar, edhe pak tek blegtorët aty. Singërisht nuk i kuptoj ata zyrtar në ministri qofshin, por qoftë edhe në nivel lokal kur janë në pyetje këto procedurat e vonesave. Unë për vete punoj qe 15 vite në shkollë, nuk e di çka është mu vonu me procedura kur ti ke me kry një punë. D.m.th për shkak mos kryerjes së punës njerëzve të caktum, blegtori atje pëson dhe kthehet pastaj i lypë rregull. Është shumë e dhimbshme. Shpresoj që mos të ndodh kjo ndonjë mas me pas blegtorët tanë, përndryshe ashtu siç thave drejtori, tha kam kontakti me zv.ministrin, të behte presion në këtë drejtim. Drejtori tha me zv.ministrin, por zv.ministri të qonë diku tjetër. Kjo është se si shoqeri na brengos, faji gjithmonë po mbetet jetim. Shpresojmë mos të kemi ndonjë mas ndëshkuese.

z.Majlinda Shabani: Unë po nderlidhem me temen që e diskutoj nënkyetari, sepse unë i përmenda disa nga obligimet, mirëpo ajo që e para duhet me u nderlidh është Qendra për Punë Sociale, të cilën nënkyetari nuk e ka përmend dhe aty përfshihen që, perpos që duhet me u ofru sigurim në qendren për punë sociale, duhet me u vendos dhe detektor dhe ngritja profesionale e punëtorëve social. Unë po besoj që nënkyetari e dinë gjendjen që e kemi të Qendrës për Punë Sociale në Komunën e Vitisë, që nuk është asnjë psikolog në Qendrën për Punë Sociale që ofron asistencë. Kemi asistencë materiale, por jo sociale. Prej 10 zyrtarëve që i ke të punsum në Qendrën për Punë Sociale, 9 prej tyre nuk kanë as të përfunduar shkollim universitar në Degën e Sociologjisë. D.m.th i ke 9 jurist në Qendren për Punë Sociale e nuk e ke asnjë psikolog që punon aty. Ajo është adresa e parë në moment që shkojnë familjet, gratë, fëmijët që ballafaqohen me dhunë fizike, psiqike, dhe rasti i fundit që ka

ndodhë në Ferizaj është pikërisht në Qendrën për Punë Sociale dhe aty duhet me u ofru siguri për me kalu në hapa tjerë. Unë e obligoj Komunën, që Komuna me i përmbush këto kërkesa në Qendrën për Punë Sociale dhe mandej me i pa mundësitë tjera të cilat janë për mëtutje.

z.Nexhat Halili: Nënkryetar, tek rruga Sllatinë - Viti është e vërtet që ka dalë me bë eliminimin e të metava, mirëpo për një kohë brenda 1 viti me u degradu ashtu rruga, kjo është e pafalshme, nuk i plotëson as standardet minimale kjo rrugë mu qujt rrugë. Tek trotuaret nënkryetar deklarove që u ndërpre kontrata, mirëpo nuk ka diku 1 javë a 2 që një operator ekonomik i ka sjellë kockat i ka drejtu i ka qitë trupat dhe i ka lanë në trotuar, nuk veprohet kërkush, nuk po e di tash a ka kontratë apo nuk ka kontratë.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës: E di që ai ka pas vitin e kalum me përfundu dhe na ka pru me shkrim që nuk muj me përfundu dhe ka qenë çështja me mbyllë, ndoshta tash është rinovu kontrata e re apo ka marrë operator ekonomik të ri. Çështja e rrugës të cilën po e thu ti se, nuk e di qysh quhet, a quhet rrugë. Unë konsideroj rrugë, se është bërë një rrugë bukur e mirë, ajo i ka garancionet e veta, nuk është bash lehtë, duhet të jemi parimor, se për herë të parë ka qenë rrugë e arave. Nuk jam unë idhtar i asaj pse i kanë ndodhë ato prishjet diku diku, por megjithatë ato duhet të rinovohen. Pas renovimit përgjegjësini e merr komisioni Nexhat, unë nuk e marrë atë përgjegjësi. Komisioni për pranim teknik formohet, del në vendin e ngjarjes e merr kontratën me veti çka ka pas me kry punëkryerësi. Në rast se konformë kontratës e ka kry, e pranon. Nuk e ka kry, nuk ja pranon.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Materialin e keni marrë me kohë, për këtë seancë kemi parapa këtë:

R e n d d i t e

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e dytë e Kuvendit Komunal.
2. Pasqyrat financiare të buxhetit komunal për periudhën janar-mars 2024.
3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për bartjen e mjeteve nga një projekt në projektet tjera në shumën prej 148.376,16 euro.
4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për ndryshim - plotësimin të vendimit Nr.01-110/05-111, të datës 01.02.2022 të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.
5. a) Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit të nismës së kryetarit të Komunës së Vitisë me Komunën e Gjilant në fushën e dhënies në shfrytëzim të lokacionit (Stacionit të autobusëve të Vitisë), me qëllim të shfrytëzimit nga NPL "Stacioni i Autobusëve Gjilan" sh.a. për realizimin e projektit me interes të përbashkët.
b) Propozim vendimin për autorizimin e kryetarit të Komunës së Vitisë për të filluar konsultimet me Komunën e Gjilanit në fushën e dhënies në shfrytëzim të lokacionit (Stacionit të autobusëve të Vitisë), me qëllim të shfrytëzimit nga NPL "Stacioni i Autobusëve Gjilan" sh.a. për realizimin e projektit me interes të përbashkët.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Hapi diskutim për rendin e ditës. Pasi që nuk ka për diskutim, a jeni që të miratohet rendi i ditës. Pra, me të gjitha votat pro miratohet rendi i ditës.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës: Më kanë ardhë këtu 2 pika të rendit të ditës, njëra është propozim vendim paraprak për dhenien në shfrytëzim të pronës komunale, kioskes, përmes ankandit publik që kemi pas në regjister që është këtu te shtëpia e kultures, dhe tjetra është për formim të komisionit. Në rast se e shef të udhës me kalu, do të ishte mirë, për shkak se ajo kishte pas me kontrat 1 vjeçare dhe është në përfundim të kontratës dhe gjithçka ta zamë me kohë.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Ne e miratim rendin e ditës.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës: E miratove atë që ke pas në propozim, kjo është me shtu, ti din, në rastë se ka mundësi.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Parimisht tash pas miratimit të rendit të ditës kur të qohet dora për rend ditës, unë nuk besoj nëse nuk është urgjente, kalon në seancën tjetër. Pas miratimit të rendit të ditës kurr nuk kemi shti më pika të reja. Kur e kemi hap diskutimin tek rendi i ditës janë propozu pikat e rendit të ditës. Përcjelli procesverbalet, pas miratimit të rendit të ditës kurr nuk kemi shti pika.

z.Illir Zuka: Realisht është qysh po thu ti, mirëpo nuk ke tu na ndëgjju nënkryetari, mirëpo unë po besoj që për shkak që pi kalojka periudha nuk është diçka që pi shkelim shumë rregullat e Kuvendit. Në qoftë se është

mundësia me qitë në Kuvend nuk e merrë përgjegjësinë ti, e marrim ne si asamblistë, se përndryshe është ashtu, se ti hape debat, por në qoftë se është mundësia me hy.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: E bajëmë praktikë të keqe këtë. Te çështja e kioskave është dhe Drejtoria e Shërbimeve Publike. Nëse nuk prishë punë, në seancën tjetër nuk jemi me pengu atë çështje.

z.Musli Neziri: Kryesues, është ashtu siç po thu ti, d.m.th asnjëherë masi kemi miratu nuk kemi shtu, kemi diskutu. Nënkryetar, a keve te ndëgju a nuk keve nuk e di, se edhe mu më iki votimi si shpejt. Ne e votum, kjo është siç po thotë kryesuesi, asnjëherë nuk kemi votu pasi kemi votu rendin e ditës me shti pika tjera. Përndryshe po bimë ne që po ka njerëz gjithë të vonum këtë aspekt, se edhe nëse është pritë fundi pse është pritë fundi. Nëse është e mundur me bë në seancën tjetër po rregulloren nuk po e thejmë.

z.Remzi Salihu: Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Meqenëse ne shpeshherë kemi diskutu për pika të tilla, por jam unë ai i cili ka ngrit zerin më së shumti në kundërshtim të këtyre pikave që na kanë ardh me vonesë aty për aty, sepse shpeshherë edhe pse i kemi shti në rend të ditës na kanë dështu ato pika që nuk du ti përmendi raste të tilla, mirëpo unë mendoj që mos me kriju si precedent kjo mos të hy në rend të ditës dhe të vazhdojmë rendin e ditës ashtu siç e miratum. Më vjen keq për parashtrusën e kërkesës kush është ai, por besoj që në mbledhjen e ardhme e shtin si pikë të rregullt e diskutojmë dhe shohim si do të shkoj procedura.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Po vazhdojmë me rend të ditës.

Si pikë e parë e rendit të ditës:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e tretë e Kuvendit Komunal

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Hapi debat për këtë pikë të rendit të ditës. Pasi që nuk ka për debat e qes në votim. Atëherë me 25 vota pro, 0 kundër, 0 abstenim miratohet procesverbali.

Si pikë e dytë e rendit të ditës:

2. Pasqyrat financiare të buxhetit komunal për periudhën janar-mars 2024

znj.Milihate Ajeti, drejtoreshë: Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Para se t'i prezantoj para jushë pasqyrat financiare, kam disa pyetje që mu kanë bërë në takimin e KPF-së. Më është kërkuar një sqarim lidhur me shpenzimet e vendimeve gjyqësore, ku janë marrë mejtet sakt. Mjetet janë marrë nga këto programe: në programin e arsimit, kategoria ekonomike e pagave në shumë prej 1 milion e 912 mijë e 623 euro dhe nga programi i Zyrës së Kryetarit. Janë marrë shumë prej 34 mijë e 107 euro në program të pagave, dhe shuma prej 16 mijë e 672 euro janë marrë nga shërbimet dhe mallra. Pyetja tjetër është bërë për disa kode ekonomike, kodi 13630. Në këtë kodë përfshihen pagesa për furnizime për barna në QKMF. Kodi 14050 përfshinë mirëmbajtjen e pajisjeve nëpër objekte, administrata, shëndësi dhe arsim. Këtu hyn edhe mirëmbajtja e ngrohjes qendrore, 11431. Në këtë kodë hynë puna jashtë orarit në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare dhe zjarrfikësve. Kodi 11411. Në këtë kodë hynë pagesat për komitetin e Kuvendit, kodi 14040 në këtë kodë hynë mirëmbajtja, mirëmbajtja e kompjuterëve apo teknologjia e informatikës. Kodi 13445. Në këtë kodë hynë kontratat individuale të zyrtareve të angazhuara apo kontratat për shërbime të veçanta. 1351, në këtë kodë hynë blerja e librave për bibliotekat e shkollave filllore dhe të mesme. 11152, në këtë kodë hynë pagesat e mjekëve dhe infermiereve që paguhen për anëtarësi për odat që janë anëtarë të tyre. 14111, në këtë kodë hynë diferenca e pageses për disa zyrtarë civil që në Ligjin e Pagave ju është zvogluar paga, prandaj në vitin e parë kompenzohet 100%, në vitin e dytë kompenzohet 50%. Më është kërkuar një sqarim për ujësjellësin Ramjan-Devajë, ujësjellsi Ramjan-Devajë, kjo kontratë është nënshkruar në vitin 2023, por punimet nuk kanë mujtë me u kry, andaj mjetet e planifikuara janë orientuar në projektet e tjera. Punimet për vitin 2024 tash kanë filluar të realizohen dhe pagesat i bëjmë krahas punimeve të kryera. Shuma prej 100 mijë euro të orientuara në projekte të tjera, tashmë nga ato projekte i bartim në ujësjellës. Po prezantoj pasqyrat financiare, të hyrat financiare për periudhën janar-mars. Gjatë periudhës janar-mars të vitit 2024, buxheti i aprovuar për të gjitha kategoritë ekonomike është 17 milion e 88 mijë e 754.27, ndërsa alokimi është 6 milion e 291 e 475.88. Shpenzime për 3-mujor janë 5 milion e 581 mijë e 295.98. Buxheti i shpenzuar për periudhën janar-mars 2024 është 88.71% në krahasim me alokimet. Kategoria paga dhe medijtje janë shpenzuar 99.28%, mallra dhe shërbime janë shpenzuar 85.30%, shpenzime komunale janë shpenzuar 98.24%, subvencionet janë shpenzuar 16.97%, ndërsa investimet kapitale janë shpenzuar 57.28%. Në

krahasim me alokimet, Zyra e Kryetarit ka shpenzuar 95.51%; Drejtoria e Administrates ka shpenzuar 85.83%; Drejtoria e Inspeksionit ka shpenzuar 65.08%; Zyra e Kuvendit Komunal ka shpenzuar 95.01%; Drejtoria për Ekonomi dhe Financa ka shpenzuar 51.01%; Drejtoria e Shërbimeve Publike ka shpenzuar 96.09%; Zyra e Komuniteteve ka shpenzuar 100%; Drejtoria e Bujqësisë ka shpenzuar 73.96%, Drejtoria e Kadastres dhe Gjeodezisë ka shpenzuar 97.42%; Drejtoria e Urbanizmit ka shpenzuar 90.94%; Drejtoria e Shëndetësisë ka shpenzuar 98.20%; shërbimet sociale ka shpenzuar 74.52%; Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport ka shpenzuar 91.97%; Drejtoria Arsimit ka shpenzuar 99.79%. Të hyrat vetanake të planifikuara dhe të realizuara janar-mars 2024, të hyrat e planifikuara për vitin 2024 janë 1 milion e 29 mijë e 502 euro, ndërsa të hyrat e planifikuara për janar-mars janë 257 mijë e 375.50 euro. Të hyrat e realizuara për periudhën 3-mujore janë 204 mijë e 335.37 euro apo në përqindje janë realizuar 79.39% në krahasim me planin 3-mujor, nëersa 19.85% në krahasim me planin vjetor krahasimi i të hyrave vetanake janar mars 2024 në të njëjtën periudhë të vitit 2023. Në periudhën janar-mars 2024 janë realizuar të hyrat më të ulta për 44 mijë e 558.91 euro në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2023, krahasimi i shpenzimeve të vitit 2024 me të njëjtën periudhë të vitit 2023. Në vitin 2024 shpenzimet në total janë më të larta për 2 milion e 631 mijë e 654 euro. Shpenzimet për paga dhe meditje janë më të larta për 2 milion e 121 mijë e 79.41 euro. Në këtë kategori janë ekzekutuar shumë prej 1 milion e 946 mijë e 730.90 euro. Këto janë vendime gjyqësore që rrjedhin nga kontrata kolektive të viteve të mëhershme, andaj kjo shumë ka ndikuar në rritjen e shpenzimeve në këtë kategori, shpenzimet në mallra dhe shërbime, komunalit janë më të larta për 286 mijë e 953.88 euro. Kategoria e subvencioneve është më e ulët për 24 mijë e 472 euro, ndërsa investimet kapitale janë më të larta për 248 mijë e 92.71 euro. Këto ishin pasqyrat financiare për 3-mujorshin janar-mars.

z.Illir Zuka: Drejtoreshë, faleminderit për prezantimin e pasqyrave financiare. Unë nuk do të diskutoj shumë, se dihet, d.m.th 3-mujori parë më shumë janë bartje të vitit të kalum, se e dimë që nuk janë bërë punë këtë vit e janë pagu. Më shumë paguhen obligime. Çka më ra mu në sy diçka, d.m.th që kemi të hyrat vetanake kemi për 19% më pak a ka ndiku edhe falja e borgjeve që kemi bë vitin e kalum. Edhe tjetra, tek donacionet vitin e kalum kemi pas 580 mijë euro, këtë vit nuk kemi ende për këto dy pika pata me i ngritë.

z.Taulant Haxhiu: Të hyrat 2024 në krahasim me 2023 kemi 44 mijë e 558. Shkalla ekzekutimit është e buxhetit 88.71%. Unë dashta të lidhem saktësisht tek Zyra e Kryetarit. Në vitin 2023 kemi pasë shpenzime 129 mijë e 511, kurse në vitin 2024 kemi 168 mijë e 859, 34 mijë e 107 kemi më shumë këtë vit. Drekat zyrtare në vitin e kalum tek kodit 16033 i ke pas të postume 4724, kurse në vitin 2024 nuk kemi askund dreka zyrtare edhe vendimet gjyqësore. Në vitin 2024 kemi 34 mijë e 107. Në vitin 2023 nuk kemi, d.m.th Zyra e Kryetarit, shpenzime veç të zyrës janë 77 mijë e 125. Tash janë 121 mijë e 797. A din me më tregu ti mu, këto vendime gjyqësore a nuk ka pas vitin e kalum a çka është problemi, dhe pse drekat zyrtare të vitit 2024. A nuk ka pas a nuk keni postu. Unë e kam bërë dallimin e vitit të kaluar dhe këtij viti.

z.Nexhat Halili: Gjatë analizës së këtyre pasqyrave financiare për 3-mujorin e parë të vitit 2024, shihet se këtu kemi diku shkalla e realizimit është 19.85%, që do të thotë që, të hyrat për këtë 3-mujor janë më të vogla për 44 mijë e 558.91 euro. Te tatimi në pronë dhe tokë, kur bëjmë krahasimin delë se është më e vogël për 50.30% për 3-mujorin, nëse bëhet në bazë të hyrave të realizuara dhe të hyrave të planifikuara. Ku është problemi që ka ardh deri tek kjo që me qenë të hyra në tatim në pronë dhe në tokë me të vogla se sa që janë të planifikuara. Pika e dytë, tek lejet e ndërimit në vitin e kaluar kanë qenë 7500 euro, ndërsa këtë vit janë 23963 euro. Tek shpenzimet shkalla e realizimit të shpenzimeve është dikune 88.71% në bazë të pasqyrës së paraqitur nga ju drejtoreshë, edhe heren tjetër tek kategoria e shpenzimeve kur ti, qitne përqindjen pak largone këtë kulon, se kjo gjithmonë është më vonë, jo në këtë faqe largone këtë kolon, mos e leni, se po del pak jo serioze. Tek shpenzimet, pagesa e vendimeve gjyqësore. Drejtoreshë, pak më heret thave se te kryetari janë 34 mijë e 107 euro vendime gjyqësore. Mu nuk po me del 34 mijë po po me del 50 mijë e 779 euro. E përveç kodit 11900 e ki edhe kodin 14900 që janë në kuadër të kryetarit. Pyetja është: këto shpenzime të mdhaja për këtë vitin 2024, në këtë tremujor, unë po kerkoj me naj dhanë qet letrën që e ke përgatit ti me e dorëzuar, me e pa se çka është problemi. Në bazë të një llogarie që unë e kam bë, del dikun që, 35.63% është shkalla e vendimeve gjyqësore në raport me shpenzimet e vitit 2024. Tek energjia elektrike ki rritje këtë vit në krahasim me vitin e kaluar për 21 mijë e 729 euro, çka ka

ndikun ketu që ka rritje, ka rritje të çmimit a po ka shtim të objekteve tek pajisjet tjera. Vitin e kaluar në vitin 2023 në tremujorin e pak i ki pas dikun 12 mijë e 736 euro, ndërsa tash në vitin 2024 i ki 118 mijë 799.89, që do të thotë 106 mijë më shumë se vitin e kaluar. Tek bleraja e librave dhe vlerave artistike, vitin e kaluar tremujorin e ki pas zero, ndërsa tash i ki 20 mijë e 860.50 euro furnizime mjekësore. Drejtoresha nuk të koka këtu e shëndetësisë. Në tremujorin e parë furnizime mjekësore të vitit të kaluar i ke pas zero, ndërsa tash i ki 24 mijë e 530 euro. Naften për ngrohje qendrore vitin e kaluar ka qenë në tremujorin e parë zero. Tash i ki 4350 euro, drutë dhe prodhimi i drunit për ngrohjen vitin e kaluar në tremujorin e parë zero, tash i ki 15 mijë e 645 euro. Një tjetër që per mua është shqetësuese, është regjistrimi i automjeteve dhe sigurimi i automjeteve vitin e kaluar i ki pas 1395 dhe sigurimi 1991, ndërsa këtë vit regjistrimi e ki 330 euro dhe 525 euro sigurime tjetra. Kodi 14022, mirëmbajtja e ndërtesave administrative dhe afariste vitin e kaluar i ki pas 40839.92. Këtë vit i ki 69784.52 çka ka ndiku këtu kur dijet që kontrata është fikse e mirëmbajtjes. Mirëmbajtja e rrugeve lokale 26 mijë e 605 euro i ki pas vitin e kaluar, këtë vit i ki 56 mijë e 017 euro, edhe e ki mirëmbajtjen rutinore vitin e kaluar zero. Këtë vit i ki 6240. Tek kodi 14310 kompenzimi i përfaqësimeve brenda vendit. Vitin e kaluar i ki 11 mijë e 620, ndërsa këtë vit i ki 6 mijë 675. Në këtë kod 14310, vitin e kaluar e ki me një përshkrim tjetër. I ki drekat zyrtare, 11 mijë e 620 euro, ndërsa tash ju ka ndërru komplet kompenzim i përfaqësimit brenda vendit. Nuk po muj me e kuptu, kodin 14410, vendimet gjyqësore që e elaborova pak me herët. Tek raporti analitik i investimeve për periudhën janar 2024, hartimi i projekteve nr. 8, emrin e kompanisë nuk po e potencoj, edhe pse është këtu 1830.47 euro. Cilat projekte janë hartu, cilat rrugë, cilat trotuare, cilët ujësjellës apo çka përfshinë në këtë? Tek nr. 4 ndërtimi i ujësjellësit në Ramjan-Navosellë, e keni vlerën 60 mijë euro. Këtë vlerë 60 mijë euro. E keni edhe tek pika tjetër që bartet prej kodit të investimeve, që dilet tek projekti i ujësjellësit, është vlera e njëjtë. Po e flasim më von tek pika tjetër e rendit të ditës. Ndërtimi i rrugëve me zhavorr nuk potencohet se cilat rrugë janë shtru me ditë përshembull cilat rrugë janë shtru. Kemi rregullimin e hapësirave gjelbëruese. Këtu i kemi dy kompani, pozicioni një dhe tre, cilat rrugë, cilat sheshe, janë gjelbru, pse po dalin dy kontrata.

znj.Zyrafete Rama: Unë kam një pyetje për kodin 11411, shtesat e veçanta për të zgjedhurit. Nëse mundesh me naj dhanë një sqarim, se puna e emërimit të këtij kodit nuk po e kuptojmë.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës: Po e marr fjalën, sepse shumë pyetje të pergjithshme, do të pergjigjem një nga një, nëse e harroj ndonjë më përkujtoni. Një çështje duhet me pas të kjar se, pasqyrat financiare paraqesin një gjendje reale që ka ndodhë brenda këtyre tre muajve. Ato para që kanë hy dhe të cilat janë shpenzu standardet e pasqyrave financiare nuk muj me i ndryshu, jane kode të cilat janë të pranueshme, sepse paqyrat auditohen çdo vit. Të hyrat në tremujorin e parë në vitin 2023. Nga të hyrat nga tatimi në pronë, ti e din që nganjëhere është vullnet i qytetarëve, shkon kërkon me pagu, ti je i obliguar me e bë një planifikim e mundet me ndodhë që në gjashtëmujorin e dytë mu rrit intensiteti i pagesave. Çështja e lejes së ndërtimeve është nga kërkesa e ndërtuesve, prandaj del ajo shumë. Te shpenzimet gjyqësore, kjo është gjithherë si pasoj e kontratës kolektive. Pjesa dërmuese janë të arsimitarëve të cilët në vzhdimësi i kemi pas këtu deri sa të pëfundon kontrata kolektive, këto po na përcjellin. Tek shpenzimet tjera, varet kur vijnë fakturat me i pagu. Edhe tek nafta për grohje qendrore, edhe tek drutë varet kur vjen fatura. Regjistrimi u automjeteve, qaq janë regjistru, qaq i kemi paraqitë në pasqyra, ka përfundu kontrata, e kemi shpall tenderin, tash derisa të lidhet kontrata. Zyrafete, pyetja jote është pagesa për komitetet e Kuvendit Komunal që paguhen.

z.Taulant Haxhiu: Pse vitin a kaluar keni pas dreka zyrtare 4700 e këtë vit jo?

z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës: Edhe këtë vit kemi drekë zyrtare.

z.Nexhat Halili: Tek mirëmbajtja e ndërtesave, rritja.

z.Basri Aliu, drejtor: Patë disa pyetje tek Drejtoria e Shërbimeve Publike. Nexhat, shumë më e madhe e rrymës. Është një faktor që është shtrëjtu pagesa e rrymës, që është rrit vitin e kaluar. E dyta është që kanë mbetë, fakturat e vitit të kaluar jan bartë këtë vit, sepse vitin e kaluar KEDS-it i kam bë presion me e regjistru, më heret me naj pru fakturat, në mënyrë që mjete kishmi që mos me na shku në suficit, dhe këtu mundet me qenë ai dallimi. Tek mirëmbajtja e rrugëve pse këtë vit më shumë. Kjo varet edhe prej të reshurave atmosferike, varet prej kohës kur kemi intervencu në rrugë me zhavar apo diçka tjetër. Për këtë janë këto shpenzime më të mëdhaja.

Pat edhe një pyetje, 6 mijë e diçka euro. Ato janë mirëmbajtja e kanalizimeve, intervenimet. Ka pas edhe rritje të pagave të punëtorët e ambientit.

Si pikë të tretë të rendit të ditës kemi:

3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për bartjen e mejteve nga një projektë në projektet tjera në shumën prej (148.376,16)euro

znj.Milihate Ajeti, drejtoreshë: Këtë propozim vendim e kemi bë për këtë arsye. Ujësjiellësi në Ramjan, të cilin në vitin e kaluar janë bart mjetet në projektet tjera, dhe tashti ju rikthehen dhe më arsyetim tjetër se, punimet janë kryer në shumë prej 60 mijë euro, ndërsa për shumën 88 mijë e 376.16 euro. Këto mjete barten në projekte të ndërimit të rrugëve me zhavor, për arsye se kompania punëkryerse i ka kryer punimet me këtë vlerë dhe me qëllim që ti përmbushim obligimet ndaj operatorit ekonomik brenda afatit ligjor prej 30 dite të bëjmë këtë lëvizje buxhetore, ndërsa plotësimin e kodit të projektit ku i marrim mjetet do të kompenzojmë me bartjen e rritjes së buxhetit me rritjen 2024, të cilin do ta bëjmë në muajt në vijim përmes Kuvedit.

z.Nexhat Halili: Drejtoreshë, në bazë të deklaratës që e thave ti ju mjetet nuk i keni. Tash deklaro se, prej realizimit të buxhetit t'i bart. Po më intereson tek projekti në Ramjan – Navosellë, 60 mijë euro parasheh në të ardhmën, kur te pozicioni i katër, prezentimi analitik i investimeve i ki 60 mijë euro. Mu po me doket interesante 60 atje 60 kha.

znj.Milihate Ajeti, drejtoreshë: 120 mijë janë krejt. Vitin e kaluar nuk kanë mujt me i kry punët dhe tash mjetet i kemi edhe 60 mijë.

z.Nexhat Halili: Po 60 i keni bë pagesë, tash po parasheh në të ardhmën, po ku i merr qeto 148 mijë, se këto pare duhet me i pas në buxhet për me i bart. Nëse nuk i ki paret, ti s'un i bart. Ti po parasheh në të ardhmen me i marr.

z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit: Eshtë kodit tek investimet kapitale për participim me donatorë. Aty i kemi dikune 400 mijë euro që janë të planifikuar për këtë vit. Unë jam konsultu edhe me Islamin, d.m.th që në bazë të punës që janë nda mjete per këtë vit, për ujësjiellësat në Ramjan dhe Naovosellë. Punët janë kry më shumë se sa që kanë nda pare. Tash kur janë kry punët më shumë se mjete që janë nda, atëhere kemi hi në obligim që me i pagu këta. Është çështja që ne paret për këta projekte nuk i kemi, i kemi mungesë, nëse dojmë me pështu pare që mos me hi ai me përmbarues me na marr pare atëhere e kemi kodin për participim që është kod për investime prej këtij kodit i pasmi. Për mu pas konsultimi që kam bë është e pranushme kjo.

z.Nexhat Halili: Kontrata sa ka qenë, a është përmblyllë kontrata? Mos ta kalon kontratën.

z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit: Pasi që nuk ka të tjerë për diskutim, qes në votim për miratim. Kush është për? Më 17 vota pro, 0 kundër, 6 abstenime kalon edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Pika e katër e rendit të ditës:

4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për ndryshim-plotësim të Vendimit Nr.01-110/05-111, të datës 01.02.2022 të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi

Materialin e keni marr, aty është ndryshimi i një anëtari të komunitetit serb.

z.Nexhat Halili: I njëjti person është edhe tek Komiteti për Komunitete. I njëjti është edhe këtu tek KKSB-ja. A lejohet i njëjti?

z.Illir Zuka: Po i njëjti është, edhe unë mendoj që nuk ka të drejtë, sepse nëse bëhet me pagesë i njëjti nuk ka të drejtë me u pagu në dy komitetet. Ministria ka me kthy prapë këtë.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës: Udhëzimi administrativ për KKSB-në i specifikon pozicionet të cilat duhet me qenë anëtar të KKSB-së. Edhe më herët ka qenë i njëjti edhe në Komitet për Komunitete edhe anëtar i KKSB-së, sepse nuk është person i zgjedhur, po vjen nga ana e komunitetit me qen anëtar i Kuvendit. Plotësisht pajtohem që nuk ka të drejtë me qenë në dy komunitete.

z.Illir Zuka: Unë e di që KKSB-ja hala nuk paguhet. Momentin që bëhet për pagesa, ai ka me zgjedh njëren, se nuk ka të drejtë me u pagu në të dyjat.

z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit: Pasi që nuk ka të tjerë për diskutim e qes në votim për miratim. Kush është për? Me 23 vota pro, 0 kundër, 0 abstenim kalon edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Pika e pestë e rendit të ditës:

5. a) Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit të nismës së kryetarit të Komunës së Vitisë me Komunën e Gjilant në fushën e dhënies në shfrytëzim të lokacionit (Stacionit të autobusëve të Vitisë), me qëllim të shfrytëzimit nga N.P.L “Stacioni i Autobusëve Gjilan” sh.a. për realizimin e projektit me interes të përbashkët

b) Propozim vendimin për autorizimin e kryetarit të Komunës së Vitisë për të filluar konsultimet me Komunën e Gjilant në fushën e dhënies në shfrytëzim të lokacionit (Stacionit të autobusëve të Vitisë), me qëllim të shfrytëzimit nga N.P.L “Stacioni i Autobusëve Gjilan” sh.a. për realizimin e projektit me interes të përbashkët

z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës: Para vetes e keni propozim vendimin. Ju e dini gjendjen e stacionit të autobusëve. Ne si qeveri lokale kemi investu, po lënia në mëshirë ka fillu edhe të keqperdoret e ku kemi pas edhe shumë media që janë interesu për një gjendje të pamirëmbajtur, sidomos te tualetet. Një iniciativë e tillë ka qenë edhe para disa vite, me gjithatë nga ana e këshilltarëve të Kuvendit Komunal nuk ka has në mirëkuptim dhe në shqyrtim të gjitha mundësive. Kemi konsideru që për momentin ndoshta edhe mirëmbajtja edhe ofrimi i shërbimeve për qytetarët do të ishte forma më e mirë e mundshme dhe prandaj kryetari i Komunës e ka pa të udhës ta paraqet para juve këtë propozim vendim, e për të cilin kërkon edhe miratimin. Ju jeni ata që vendosni, po unë besoj që edhe në KPF e kam thanë që, formula e përbashkët e pozitës dhe e opozitës është që, në këtë gjendje nuk duhet me e lanë, duhet me dal nga kjo gjendje dhe një nga format është kjo. E kemi shqyrtu edhe çështjen e formimit të një kompanie në kuadër të Komunës së Vitisë e cila kërkon shpenzime të mëdhaja, kërkon edhe formimin e një bordi, i cili krejt këto në pamundësi për me i kry do të ishte mirë që me të vërtet me ja dhanë një kompanie e cila për këtë çështje është e specializuar. Cili do të jetë përfitimi i Komunës së Vitisë. Do të jetë ofrimi i shërbimeve të qytetarëve shumë më i mirë dhe punësimi i 5-6 personave të cilët mund të punësohen.

z.Remzi Salihu: Përshendetje të nderuar të pranishëm! Nuk do ta elaboroj këtë pikë të rendit të ditës po do të jem konkret që të u la hapësirë të tjerëve që të diskutojmë. Unë po flas në emër të grupit të LVV-së. Të nderuar kolegë, të dashur qytetarë, siç e dini edhe ju, kjo është hera e dytë që po diskutohet për këtë temë, për dhënien në shfrytëzim të lokacionit, stacionit të autobusëve në Viti, stacioni të autobusëve në Gjilan për realizimin e projektit me interes të përbashkët, dhe qëndrimi i LVV-së për këtë çështje është i ditur. Gjithashtu nga vendimi i parë i këtij Kuvendi, endja, sjellja sërish të njëjti siç ka qenë më heret. Neve si LVV na le për të dëshiruar se, ketu kemi të bëjmë me një los sa për të thanë se ja se si ekzekutivi po bëjmë përpjekje për të hecur përpara. Po janë të tjerat që po na pengojnë. Sa i përket kësaj çështje, ne si LVV mendojmë se, zgjidhja më e mirë do të ishte që, ky stacion t'i jepet nën menaxhim një kompanie nga Komuna e Vitisë, e cila mund ta menaxhoj me sukses e që si rezultat i saj do të ishte se, profitet do të mbesin të gjitha në Komunën e Vitisë e jo të ndahen në Komunën e Gjilantit. Dhe krejt në fund, në mënyrë se si është paraqitë propozim vendimi për këtë nismë, ne si LVV nuk e përkrahim dhe vota jonë do të jetë kundër.

z.Illir Zuka: E kemi diskutu disa here në Kuvend, objektet që po rregullohen, punët po kryhen po nuk po ka mirëmbajtje e po dëmtohen. Unë e di që grupi i LVV-së e ka shfrytëzu këtë lënie anash që su kanë në mirëmbajtje. Stacioni i autobusëve në mënyrë më të mirë të mundshme që një muaj ditë nuk ka lanë media e televizion pa përdor, se në çfarë gjendje është stacioni i autobusëve në Viti. E sot realish sot kam pritë që, të parët që do të duan të trokasin është grupi i LVV-së. Realish kam pritë më së shumti për këtë pikë që do ta kemi prej Liridona Bislimit, që u mundu me e shfrytëzu më së shumti, kështu që shumë keq këtë që e nita prej profit, jashtëzakonisht u nita keq, se po mundohen me ba politikë të pabërë, që nuk funksionon kjo mënyrë. Ne po lutemi mos me lanë stacionin në qat gjendje edhe voj që janë kundër, e ne në emër të grupit të LDK-së do ta përkrahim këtë propozim vendim dhe çdo propozim tjetër që është në interes të qytetarëve të Komunës së Vitisë.

znj.Liridona Bislimi: Sa i përket kësaj çështje, sipas kolegut Ilir, të nderuar të pranishëm, çdo keqmenaxhim, çdo mospërfillje nga ekzekutivi komunal, me thanë të drejten nga kryetari i Komunës ne duhet me heshtë. Ilir,

sipas teje unë pasna dal në media e të jesh i bindur i nderuar koleg, nuk ekziston vetëm Komuna e Vitisë në Republikën e Kosovës që mediat me ardh vetëm në Viti. Mediat kanë shumë hapësirë që me u merr me tema të ndryshme, mirëpo ata e vlerësojnë cilësinë dhe sasinë se sa është e nevojshme me u bë mediatike. Besoj që për ta ka qenë e tmerrshme nëse për juve nuk ka qenë e nevojshme me u bë mediatike, edhe me u diskutu. Sa i përket pikës së stacionit, unë kam qenë gjatë mandatit të kaluar pjesë e KPF-së, e kemi refuzu edhe e kemi lëshu mbledhjen e KPF-së në shej të revoltës së bashku me kryesuesin e tanishëm. Ti ka qenë dashur me e ditë përgjigjen time, sepse ke qenë atëhere tu punu në Komunë, kështu që, përgjigja im është e njëjtë. Ju e dini se çfarë dredhina e çfarë lojna keni bë me pjesën e stacionit. Ke qenë pjesë e institucionit atëhere, e din që kryetari, Sokol Haliti ka tentu me manipuliu në forma të ndryshme me pjesën e stacionit, kështu që, ne jemi kundër kësaj. Përgjithësisht mendoj që, kjo është ikje e përgjegjësishë institucionale, asgjë tjetër. Neve na duhet një ndërmarrje komnale. Komuna duhet me i pas mekanizmat edhe stacioni duhet me qenë nën menaxhimin e Komunës së Vitisë.

z.Illir Zuka: Kam qenë nga ata që më së shumti kam kërku. Unë edhe Sejda të jemi shumë real, kemi kërku prej stadiumeve që të kenë mirëmbajtës që punët që po përfundojnë të kenë mirëmbajtje në mënyrë që është stacioni mos mu lanë. Nëse vazhdojmë kështu, prapë po mbet keq, kujt po i konvenon.

z.Taulan Haxhiu: Unë në emer të grupit të PDK-së, ne asetet publike të Vitisë jemi gjithmonë të shfrytezohen nga Komuna e Vitisë, jo të shkojn pa asnjë interes publik në Gjilan, edhe të gjith ata që janë tek stacioni i autobusëve janë që mos të shkon me Gjilan, edhe nuk është e mirë. Vota e PDK-së është kundër.

znj.Majlinda Shabani: Mendoj që kjo që duhet me diskutu është gjendja e tualeteve. E ka sipërfaqen komplet qat far horrorin që e kemi pa edhe që ka bë buj të madhe. Kjo ka ardh pikërisht prej mediave, andaj kjo duhet me u pa në aspektin pozitiv kur një gjendje e tualeteve është sipërfaqe taman qat mënyrë si u kanë ka ardhe deri në këtë pikë, sa që ne sot jemi tu diskutu për stacionin e autobusëve. Tash e sa vite qaj stacion ka qenë jo funksional. Unë kam hi i kam pa pasqyrat financiare të vitit 2017-2018, ku komna për ndërtimin e stacionit të autobusëve ka shpenzuar dikune 19 mijë e 907 euro. Aty janë taksa të qytetarëve, ato janë pagu me taksa të qytetarëve, në anën tjetër e kemi një kryetar i cili del në publik dhe ja jep vetes noten 10 për qeverisje, për projektet, për investimet që i banë e në anën tjetër e kemi një projek që pikërisht në qendër të Komunës së Vitisë e cila e ka marr atë pamje, e cila shfrytëzohet për dukuri negative nga të rinjët, dhe në anën tjetër e kemi një drejtori e cila nuk është në gjendje me e marr përgjegjësinë për me e rujt atë objek. Minimumi ka qenë për me rujt objektin në rast se paska dështu për me funksionaliziu qat objekt. Tjetra, qekaq komuna e lodhur a që nuk kemi asnjë person që mundet me e ba një plan qeverisës për me e menaxhu qat stacion. A nuk mundemi ne si komunë me e formu një kompani edhe për me bë menaxhimin e stacionit? A keni bë ndonjëhere llogari për afërsisht se sa në vit mundet me humb komuna prej taksave për shfrytëzim? Nuk e keni bë këtë llogaritje dhe në anën tjetër asetet e komunës po i japim për shfrytëzim dikun tjetër. A e kish leju në këtë rast Gjilani apo Ferizaji ose komunat tjetra një gje të tillë dhe në anën tjetër e kemi rastin kokret me “Eko – Higjienën”, kështu që kryetari pas krej kësaj sot vjen në Kuvend, diskutohet që stacioni i komunës në vend që me ardh me një zgjidhje, në këtë rast me u bë menaxhimi i duhur, kryetari për me largu përgjegjësinë nga ana e tijë vjen me një propozim të tillë, andaj kjo normalish që eshte e papranushme. Është mirë me u ul nënkryetar bashkë me ekzekutivin me e diskutu edhe me ardh në Kuvend me nje propozim konkret, më të mirë, ku asetet e komunës shkojnë për komunën. Të ardhurat shkojnë për qytetarët e Komunës së Vitisë.

z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit: Stacioni është funksional, se krejt shërbimet kryhen. Aty mirëmbajtja nuk ka qen në nivel dhe mirëmbajtja e stacionit ka tregu që ajo nuk është në rregull. A duhet me u menaxhu, definitivisht që duhet. E duhet mu gjetë një formë më e mirë për komunën edhe për kompanitë e për nxënësit, se zakonisht ai përdoret për nxënësit se, nuk është që shfrytëzohet shumë për udhëtar. Na mund me dhanë mendime pro e kundër, po për me bë një zgjidhje për stacionin e autobusëve, për me pas një çështje më të mirë.

z.Basri Sylejmani: Na nuk jemi kundër që kjo e propozon, po kjo mundet me thanë që edhe asfaltin me shku me e jek në Lubishtë që e ka shtru kryetari. Kryetari s’a fajtor për stacion të autobusëve. Aty punohet tepër mirë. Është ai stacion qysh janë tu punu, qysh janë tu e shfrytëzu. Juve asnjehere nuk po ju vjen përshtati, ju gjithë po

sa me i dhanë punë dhe Komunës së Gjilanit. Jemi një ndër komunat më të varfra në Kosovë. Ju diskutoni me ja dhanë dhe një stacion një ndermarrje. Nuk muni me kriju, se ato ndërmarrje që kanë ekzsitu i keni shkatrru. Tash kërkoni që edhe këtë ministacion me ja dhanë Komunës së Gjilanit. Definitivisht është turp, marre, ofendim ndaj qytetarëve të Vitisë. Për atë unë edhe votoj kundër.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës: Unë besoj që ndoshta nuk prishë punë, ndesh nënkryetari, ndesh kryetari me mbrojtë propozimin. E drejta ligjore është edhe aty ku është kryetari, është me punë ndoshta shumë të rëndësishme, që kjo nuk duhet me të ardhë brengosese kjo shumë. Tjetra, e turpshme. Unë nuk konsideroj që ka turpni këtu. Ndoshta ky fjalori yt është më i turpshëm se propozim vendimi. Në rast se i marrim kështu me i kqyrë, por megjithatë është përzgjedhja jote. Ti e ke zgjedhë atë rrugë, nuk është ofendim i qytetarëve në rast se i ke ofru ndërtesë që me qader kan nejt aty, se qekjo qeveri i ka ndreq, se ajo ka qenë përtokë e rrafshume ka qenë, janë shitë aty për hektra, çkas kanë ba dhe nuk është turpni, por është ofrim i kushteve më të mira me pritë në zotnillak, po ajo ndërtesë tash kërkon mirëmbajtje, mos me lanë se janë invesu. Aty kemi pas ide për me investu, kemi investu. Ky është një prej propozimeve të cilet ju ka ardh. Ju jeni ata të cilët ti jo se nuk ke qenë në atë mandat. Ndoshta do të ishin nij keq ata këshilltarë. Unë do ta kisha nij veten keq sikur e kam stopu dhe e kam pru në këtë gjendje. Ti nuk ke qenë, nuk mundem me të fajsu, edhe unë nuk kërkova që të ja japim përhere. Momentalisht e kemi këtë gjendje. A dalim prej kësaj situatë, krejt thojnë po. Ëshë një prej formave që tu ka ofru. Kjo formë brenda 15-20 dite mundet me u kalu dhe e shef për 1 vjet a u kanë e mirë a nuk u kanë. Ne nuk jemi tu ja dhanë të përhershme. Formë tjetër e thirrjeve të cungon ligji. Cila është që të cungon. Nuk mundesh me thanë po ja japë një kompanisë që operon në Komunën e Vitisë, se qohet ndoshta prej Ferizajt dhe të hinë ta merrë. Dhe ku tani na, çka kemi ba na shtrohet pyetje, se ligji kerkan nuk mund ta përjashton prej garës. Krejt kanë të drejtë me konkuru.

z.Durim Sylejmani: Sa pare jan nda për pastrimin dhe mirëmbajtjen e objekteve komunale për 1 vit, sa është kosto?

z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës: Nuk e di sa është kosto, aq sa ka pas nevoj.

z.Durim Sylejmani: Gjysmë milion ose sa. Pse nuk ka hi edhe ky objekti i stacionit?

z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës: Nuk më paske ndëgju. Aty bahet mirëmbajtja deri në ora 4, dhe ky kërkon edhe pas orës 4-ër. Frekuentimi më i madhë i nxënësve është në mëngjes dhe prej ores 6 deri 7.

z.Durim Sylejmani: A shfrytëzohen edhe pas ores 4 objektet komunale, këto që pastrohen?

z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës: Jo, përveç shtëpisë së shëndetit, nuk shfrytëzohen.

z.Durim Sylejmani: Shtëpia e shëndetit, shtëpisë së kulturës, se këtu mbahen do vallëzime. A shfrytëzohet?

z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës: Po veç mirëmbajtja mbahet deri në 4.

z.Durim Sylejmani: E kur të shfrytëzohet më vonë çka bahet? Pastrohet nesër në mëngjes prapë? Edhe aty njëjtë ka mujtë me ja bë.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës: Jo, aty frekuentojnë 1 mijë, nuk jan 10 vetë. Ata 10 vetë dhe ata që vijnë janë njerëz të pjekun që menaxhohen prej dikujt. Aty janë nxënës.

z.Sejdi Emini: Aty as deri në ora 4 nuk punon askush. Nëse punohet deri në ora 4 nuk vjen në atë gjendje.

z.Basri Aliu, drejtori: Unë po e bëjë një pyetje. A keni ndëgju diku që stacionet e autobusëve janë nën menaxhimin e shërbimeve publike. Nuk po e di pse po i bëni këto pyetje në këtë formë. Për menaxhim janë kompanitë tjera, janë publike si stacioni i Gjilanit.

znj.Majlinda Shabani: Drejtor, je tu keqkuptu. Jo mu menaxhu, me u mirëmbajtë shërbimet publike. Përfshihen dhe aty a e keni pa gjendjen drejtor në çfarë gjendje është.

z.Durim Sylejmani: Dua të ju përgjigjem drejtorit. Nuk ka komuna tualet publik, janë kthyer në private.

z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit: Faleminderit për diskutimet. Objektet që janë objekte komunale duhet të mirëmbahen nga Drejtoria e Shërbimeve Publike. Ajo çka ipet në menaxhim mbahen prej atyre që e menagjojnë. Përderisa nuk jepet në menaxhim, d.m.th është objekt komunal, duhet me u mundu me kushte, me mundësi që janë me u mirëmbajt sikur objektet tjera që mirëmbahen. Vështirësi ka sa dush. Duhet me gjetë një formë më të mirë qysh me bë. Na ka ardh propozimi që e keni para vetes dhe unë pas diskutimeve që keni bë e qes në votim. E kemi nën a dhe b që duhet të votohen 2 pjesë. Pjesa nën a, propozim për shqyrtimin dhe miratimin

jeni kundër. Me themelu kompaninë duhet me pas buxhet, duhet bordi, punëtorët e tjerë e duhet kogjo buxhet. 15 punëtorë duhet më së paku me i pas.

z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit: Nuk e di a jeni kanë në stacion të Gjilanit, në qet gjendje është edhe ai atje, edhe pse menaxhohet.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës: Tash momentalisht ju e keni propozim vendimin para juve që, ne e kemi parapa si ekzekutiv, që për momentin është më e mira e mundshme. Nuk e thash rasisht se krejt pajtohemi se a duhet me dal prej kësaj gjendje. Po, po megjithatë unë po besoj se çështjen e etikës së këshilltarit duhet ta runi, se me i thanë kryetarit se po manipulon edhe me këtë formë, unë konsideroj që është e papranushme Liridonë. Një here e përgjithmonë duhet të korigjohemi, se për mi thanë dikujt që po manipulon. S'a manipulim. Në momentin kur ta ka pru propozimin, ju jeni ata që e shqyrtoni. Unë asnjëhere nuk ta thash pse i ki pru mediat, qato media më kanë thirrë edhe mu. Ju kam thanë vetëm hajdeni një ditë më vonë, se atë ditë isha shumë i zanun, sepse kryetari nuk ishte këtu, se qet kryetar që ti po e quan manipulant e ka gjetë rrafsh përtoke qaty që do qeveri përpara e kanë shit për hekur stacionin e autobusëve. Ti e dinë dhe kanë pritë njerëzit tek stacioni i autobusëve me qader, dhe vullneti i kryetarit të komunës u kanë për me e bë një ndërtesë e cila frekuentohet nga 3000 vetë në ditë apo 500, nuk po e di, po kapaciteti i qetij stacioni për atë që po e kërkoni ju, nuk krijon asi të hyra më kriju një kompani me ba bordin, etj, etj. Çështjen e lokalizimit bukur shumë e kam të shprehur nga vet unë. Nuk kisha dëshirë kurr me ja dhanë, por megjithatë ndoshta të ish bisedu sot me ja caktu një afatshmëri dhe të formohet një komision dhe të bëhet, cilado të jetë formualë me e leverdishme për të ardhem, jam edhe unë, po koha nuk na premt. Na kemi me dal nga kjo gjendje, mos me këtë variant me një variant tjetër. Ata të cilët kanë pas ide për me e ndërto kemi me ja gjetë edhe formulën, po po më vjen befasi nga këshillarët që me i stopu këto çështje, dhe lënia në këtë situatë ka keqpërdorim. E di që ka propozime që Drejtoria e Shërbimeve Publike, kjo drejtori në ora 4 e përfundon orarin e punës në rrethana normale e aty deri në ora 7-8 në mbrëmje ka frekuentim e nuk munden mu mbyll në ora 4 tualetet, kjo nuk funksionon. Mundeni me thanë po ja japim për një vit me pa çka po banë, ama jo me qenë bllokues. Mirëpo, ju jeni ata që vendosni.

z.Basri Aliu drejtor: Kjo është në domenin e juaj si do të vendosni. Unë do të ju jap disa të dhëna e ju vendosni vet. Është bë një fizibilitet rreth kësaj çështje. Nëse komuna do të krijoj një kompani të veten, do të këtë bordin e drejtorëve, kryeshefin ekzekutues, sekretarin, zyrtarin financiar, shefin operacional, biletashitësin dhe zëvendësues. D.m.th, gjithsej dalin 3770 euro mujore pagë nëse e formon kompaninë komuna, ndërsa nëse ia japin stacionit të autobusëve të Gjilanit, aty do të punësohen 7 persona dhe do të jete paga mujore 1160 euro. Po du me thanë me këtë se, nuk mundet të krijoj të hyra stacioni i autobusëve. Nëse ne e krijojmë kompaninë, atëherë duhet që të vendosim edhe komuna, ti financon ose ti mbaj ata me rroga, kështu që, kjo është gjendja, ju vendosni si me tutje.

z.Sejdi Emini: Problemi qëndron, a ka mundësi me u dhan në të njëjtën formë siç janë dhanë parkingjet qetu në qendër të qytetit, një kompanie me nje kontratë dyvjeçare ose trivjeçare, me qenë e Vitisë. E njëjta formë, se edhe kjo ka qenë pronë e komunës. A ka mundësi edhe stacioni me i ndjek qato procedura që me marr dikush i Vitisë për një kohë të caktuar, derisa të bëjmë një zgjidhje më të mirë.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës: Sejdë, nuk ta garanton thirrja që e merr një qytetar i Vitisë, ndoshta vjen dikush nga Prishtina.

z.Remzi Salihu: Unë nuk thash ta formojmë një kompani enkas, po ta gjejmë të ja japim një kompanie të Vitisë që operon në Viti dhe të menagjoj, ky është mendimi i jonë.

z.Ramadan Deliu: Unë po mendoj që masi u deklarun edhe PDK-ja edhe LVV-ja që nuk e votojmë, mos me qit hiq në votim, po me këqyrë tjetër mënyrë me qit në ankand publik.

z.Durim Sylejmani: Përshendetje të nderuar të pranishëm! Sa i përket këtij propozimi nga kryetari. E para është etikë morale dhe politike që, kur të propozon duhesh me qenë prezent. Po meqë nuk është ai dhe vartës i tij, sot është Hasani. Unë e kam një pyetje edhe për drejtorin i cili tha se, kosto është 3000 euro dhe nuk kemi llogari me i pagu sa punëtorë i kemi me kontrata mbi vepër, edhe çka bajnë ata. Kjo është pyetje për drejtorin. Sa i përket këtij propozimi që po e mbron me fanatizëm edhe nënkryetari, unë po du me thanë që ky është ofendim ndaj qytetareve të Komunës së Vitisë dhe ndaj Komunës së Vitisë. Aq e pasur është Komuna e Vitisë,

e propozim vendimit për nismen e kryetarit të Komunës së Vitisë me Komunën e Gjilanit në fushën e dhënies në shfrytëzim lokacionin e stacionit të autobusëve, me qëllim të shfrytëzimit nga npl stacioni i autobusëve në Gjilan, shoqëri aksionare për realizmin e projektve në interes të përbashkët. Kush është për këtë nismë të kryetarit të komunës. Pra, me 9 vota për, 13 kundër, 0 abstenim, nuk kalon kjo nismë. Përderisa nuk kalon kjo nismë, kjo që është nën b nuk votohet, sepse nuk mundesh me bë autorizim nëse nuk ka nismë. Faleminderi për kontributin! Shihemi në seancat e radhes.

Mbledhja përfundoi me punë në ora 12:30 min.

Procesmbajtësi:
Fatlum Demiri

Kryesuesi i Kuvendit Komunal:
Bekim Azizi

PIKA E DYTË E RENDIT TE DITES



Republika e Kosoves
Republika Kosova
Republik of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Pranuar - Prillogë Më/Dana			
Nr./ organit Org.broj	Numeri/Broj	Shtojcë Prilog	Vlera Vendoset
02-	035/02-		651



Komuna e Vitise
Opstina Vitina
Municipality of Vitia

Në bazë të nenit 58 pika h të Ligjit mbi Vetqeverisjen Lokale Nr.03L-040(Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008 lidhur me nenin 50 shkrona I të statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491 të dates 21.04.2011,lidhur me neni 6 paragrafi I, pika 1.1, neni 8 paragrafi I pika 1. 1 lidhur me neni 14, te Ligit me Nr. 06/L-092 për Dhenien ne Shfrytezim dhe Këmbim te Prones se Paluajtshme te Komunes (Gazeta Zyrtare Nr. 10, prill 2019) ,Kryetari i Komunës në bazë të kompetencave dhe autorizimeve ligjore propozon këtë:

PROPOZIM VENDIM

Paraparak per dhenien në shfrytezim të pronës komunale(kjoskës) përmes ankandit publik Neni 1

Me kete propozim vendim, Kryetari i Komunës se Vitise propozon vendimin paraparak per dhenien ne shfrytezim te prones se paluajtshme kjoskës te Komunes se Vitise ne shfrytezim afatshkurter personave fizik dhe juridik, si ne vijim:

1. Lokali-kjosku tek shtepia e Kulturës Gursel e Bajram Sylejmani ka 16 metra katror

Neni 2

Afati kohore per dhenien ne shfrytezim te pronës se paluajtshme komunale eshte afat shkurtër me kohëzgjatje prej 15 viteve,

Neni 3

Qellimi i dhënies ne shfrytezim te prones komunale eshte interesi publik dhe perfitimi ekonomik i komunes nga prona komunale.

Neni 4

Procedurat per dhënien e prones se paluajtshme komunale ne shfrytezim afatshkurtër realizohet permes ankandit publik, ne harmoni me Ligjin Nr.06/L092 per Dhenien ne Shfrytezim dhe Këmbim te Prones se Paluajtshme te Komunes.

Neni 5

Mënyrat dhe kushtet e shfrytezimit te prones se paluajtshme do te percaktohen me kontrate, e cila lidhet dhe nënshkruhet ne mes te kryetarit te Komunes dhe përfituesi i marrjes ne shfrytezim të pronës se paluajtshme ne periudhe afatshkurtër te shfrytezimit, me te drejte te shkeputjes se kontrates edhe para afatit, nëse kjoskui i dhëne ne shfrytezim nuk shfrytezohet -keqperdoret

Neni 6

Ky propozim vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë.

Propozues, Kryetari i Komunës së Vitisë

Sokol Haliti





Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture /
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVES / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-70101007-02591-0

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number: 639/2024
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme Izdavanja / Date and time of submission: 14.05.2024 - 14:10
Komuna / Opština / Municipality: VITI / VITINA / VITI
Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Viti / Vitina / Viti
Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office: VITI / VITINA / VITI

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësisë kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësisë Vrsta jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta Imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m ²)	Pershkrim Opis Description	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
P-70101007-02591-0	PARCELE / PARCELA / PARCEL	Pronë shoqërore / Društvena Imovina / Socially owned Land	Urban	6003		24.02.2014	

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i quajtur Mesto zvano Called place	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Krijuar më datën Stvadjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
			24.02.2014	



M. Ball

A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Numri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta koriscenja parcele Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenutno koriscenje parcele Parcel Current Use	Kualiteti i klasës Kvalitet klase Quality Class	Sipërfaqja (m ²) Površina (m ²) Area (m ²)
1	Tokë Ndërtimore/Građevinsko zemljište/Construction land	Shëpi-Ndërtëse/Kuca-Zgrada/House-Building		6003

B. PRONARË/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Liceni broj ID. No.	Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi postal Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojednosti adrese Address details	Pjesa e pronës Deo imovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhuruar Azurirano Updated
Poseidim individual / Individualna Druzavina / Single possessor	Komuna e Vitisë	600424486	///		28 NËNTORI	1/1	permisim i emri.	24.02.2014




REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : VITI
Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Viti



Shkalla/Razmera/Scale: 1:825

Punoi/Obradio/Created: Kushtrim Imeri

Nënshkrimi/Potpis/Signature:


Shënim/Beleška/Note:



Data/ Data/Date: 15.05.2024

Koha/ Vreme/ Time: 09:22:48

PIKA E TRETË E RENDIT TE DITES



Republika e Kosoves
Republika Kosova
Republik of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Pranuar - Prinjero Më/Dana <u>24-04-2024</u> vit/год			
Nr. l organit Org. broj	Numri/Broj	Shtetë Prilog	Vlera Vrednues
02-	035/02-		652



Komuna e Vitise
Opstina Vitina
Municipality of Vitia

Në bazë të nenit 58 pika h të Ligjit mbi Vetqeverisjen Lokale Nr.03L-040(Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008 lidhur me nenin 50 shkrona l të statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491 të dates 21.04.2011, nenit 17. pika 2. lidhur me neni 6 paragrafi I, pika 1.1, të Ligjit me Nr. 06/L-092 për Dhenien ne Shfrytezim dhe Këmbim te Prones se Paluajtshme te Komunes (Gazeta Zyrtare Nr. 10, prill 2019) ,Kryetari i Komunës në bazë të kompetencave dhe autorizimeve ligjore propozon këtë:

PROPOZIM VENDIM

Për formimin e Komisionit vlerësues dhe zbatimin e procedurave per dhenien e prones paluajtshme te komunes –Kjoskut tek Shtepia e Kulturës” Gursel e Bajram Sylejmani “ne shfrytëzim afatëshkurt prej 15 viteve.

Neni 1

Me kete propozim vendim Kryetari i Komunes se Vitise propozon vendimin per formimin e Komisioni per vlerësitmin e procedurave per dhenien ne shfrytëzim te prones se paluajtshme te kKomunes se Vitise: Komisioni propozohet prej 5 anetareve, dy nga ekzekutivi, dy kuvendi i komunes dhe nje nga shoqëria civile.

Albulena Haxhiu, anetar i komisionit (perfaqësues i ekzekutivit te komunës)
Driton Halabaku, anëtare e komisionit (perfaqesuese e ekzekutivit te komunes)
(perfaqesues i kuvendit te komunës, subjekti LDK)
(perfaqesues i kuvendit te komunës subjekti LVV)
(perfaqesues i sektorit joqeveritar).

Neni 2

Me këtë propozim vendim detyrat e Komisionit nga neni I i ketij propozim vendimi jane percaktuar ne Ligiin per dhenien shfrytezim dhe Kembim te Prones se Paluajtshme te Komunes Nr.06/L-092, i Kuvendit te Republikes se Kosoves (Gazeta Zyrtare e Republikes se Kosoves me Nr. 10, te dates 03.04.2019).

Komisioni vlerësues udhëheq me procedurat mbi dhenien e pronës se paluajtshme komunale ne shfrytezim pergatit kriteret e ankandit, percakton qmimin fillestar, zgjedhet kryetari i komisionit,vlereson ofertat.

Neni 3

Ky propozim vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë.

Propozues, Kryetari i Komunës së Vitisë

Sokol Haliti



PIKA E KATËRT E RENDIT TE DITES



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo

REPublika e Kosovës - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Pranuar - Primljeno Më/Dana <u>14-05-2024</u> v.k.pod			
Nr. i organit Org. broj	Numri/Broj	Shtetçë Prilog	Vlera Vendimet
02-	035/02		721



Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipal Vitina

Në bazë të nenit 13, të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, në harmoni me nenin 51.1 të Statutit të Komunës së Vitisë Nr. 01-013/491, të datës 21.04.2011, kërkesen e Ministris së Administrimit të Pushtetit Lokal me nr. 020-238/-6 e datës 13.05.2024, Kryetari i Komunës së Vitisë, paraqet këtë:

PROPOZIM VENDIM

Për shfuqizimin e vendimi për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale përmes shprehjës së Interesit në fshatin Budrikë të Komunës së Vitisë për vendosje të bizneseve në Parkun Industrial në Budrikë me numer protokolli 01-110/05-306 të datës 29.03.2024

I. Kryetari i Komunës i PROPOZON Kuvendit të Komunës së Vitisë që të miraton vendimin për shfuqizimin e vendimit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale përmes shprehjës së Interesit në fshatin Budrikë të Komunës së Vitisë për vendosje të bizneseve në Parkun Industrial në Budrikë, vendimi me numer protokolli 01-110/05-306 të datës 29.03.2024.

II. Me këtë propozim- vendim, i propozohet Kuvendit të komunës së Vitisë që të shfuqizoj vendimin për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale përmes shprehjës së Interesit në fshatin Budrikë të Komunës së Vitisë për vendosje të bizneseve në Parkun Industrial në Budrikë, vendimi me numer protokolli 01-110/05-306 të datës 29.03.2024, kërkesen e Ministris së Administrimit të Pushtetit Lokal me nr. 020-238/-6 e datës 13.05.2024.

III. Ky vendim hyn fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë

Kryetari i Komunës:
Sokol Haliti



DDALESE - IZLAZNA - OUTGOING
 REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLICA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
 QEVERIA E KOSOVES / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVO
 Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
 Ministarstvo Lokalne Samouprave / Administracija
 Ministry of Local Government Administration
 Nr. 020-238/6
 -VI-
 Data: 13.05.2024
 Data:



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
 Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
 Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
 Ministry of Local Government Administration

Për:	Sokol Haliti, Kryetar i Komunës së Vitisë Bekim Azizi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë	
Kopje:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së Jeton Qela, Ud. Sekretar i Përgjithshëm në MAPL	
Nga:	Erblin Hetemi, Ud. Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorimit të Komunave, MAPL	Datë: 12.04.2024 VI-020-238
Zyrtaret përgjegjës:	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave Leonora Bajrami, Zyrtare për Monitorim të Komunave	
Lënda:	Kërkesë për rishqyrtim	
Lloji i aktit:	Vendim i kuvendit të komunës së Vitisë	

I nderuar Kryetar,
 I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, si dhe Rregulloren nr. 06/2021 për ndryshimplotësimin e Rregullores (QRK) Nr. 10/2019, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 14/2023 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendim 01-110/05-306 për dhënien në shfrytëzim afatgjate të pronës komunale përmes shprehjes së interesit në fshatin Budrikë të komunës së Vitisë për vendosje të bizneseve në parkun industrial në Budrikë
I miratuar më datë: 28.03.2024
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 03.04.2024

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si mësipër, vlerëson se akti i komunës nuk është në pajtim me dispozitat e legjisfacionit në fuqi.

Arsyetim

Kuvendi i Komunës së Vitisë në mbledhjen e mbajtur me datë 28.03.2024, ka miratuar Vendimin 01-110/05-306 për dhënien në shfrytëzim afatgjate të pronës komunale përmes shprehjes së interesit në fshatin Budrikë të komunës së Vitisë për vendosje të bizneseve në parkun industrial në Budrikë i nxjerrë nga Kuvendi i Komunës së Vitisë.

MAPL, konstaton së vendimi i nxjerrë nga Kuvendi i Komunës së Vitisë është në kundërshtim me Ligjin 06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës pasi që ky ligj nuk rregullon dhënien e pronës në shfrytëzim për Zonat Ekonomike.

Baza ligjore e vendimit ti referohet legjislacionit përkatës që rregullon vendosjen e bizneseve në parkun industrial e rregulluar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë.

Andaj bazuar në të lartcekurat, Kuvendi i Komunës së Vitisë, duhet të ndërmer veprime dhe brenda afatit ligjor, prej 30 ditëve, të rishqyrtoj dhe të harmonizoj aktin më legjislacionin në fuqi.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbete në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me këtë vlerësim.

PIKA E PESTË E RENDIT TE DITES



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Pranuar - Prilijeno Më/Dana 14-05-2024 vll.pod			
Nr. i organit Org broj	Numri/Broj	Shtojcë Prilog	Vlera Vredmose
02	035/02		722



Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipal Vitina

Në bazë të nenit 13, të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, në harmoni me nenin 51.1 të Statutit të Komunës së Vitisë Nr. 01-013/491, të datës 21.04.2011, kërkesen e Ministris së Financave, Punës dhe Transfereve me nr 020-238/4 e datës 24.04.2024, Kryetari i Komunës së Vitisë, paraqet këtë:

PROPOZIM VENDIM

Për shfuqizimin e vendimit për Financimin e shujtave ditore për sherbyesit civil si dhe stafin teknik dhe mbështetës të Komunës së Vitisë janar-dhjetor 2024, vendimi me numer protokolli 01-110/05-308 të datës 29.03.2024.

I. Kryetari i Komunës i PROPOZON Kuvendit të Komunës së Vitisë që të miraton vendimin për shfuqizimin e vendimit për Financimin e shujtave ditore për sherbyesit civil si dhe stafin teknik dhe mbështetës të Komunës së Vitisë janar-dhjetor 2024, vendimi me numer protokolli 01-110/05-308 të datës 29.03.2024.

II. Me këtë propozim- vendim, i propozohet Kuvendit të komunës së Vitisë që të shfuqizoj vendimin për Financimin e shujtave ditore për sherbyesit civil si dhe stafin teknik dhe mbështetës të Komunës së Vitisë janar-dhjetor 2024, vendimi me numer protokolli 01-110/05-308 të datës 29.03.2024, me kërkesen e Ministris së Financave, Punës dhe Transfereve me nr 020-238/4 e datës 24.04.2024.

III. Ky vendim hyn fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë

Kryetari i Komunës:
Sokol Haliti



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
 Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo
 Ministria e Financave / Ministarstvo za Finansije
 Ministry of Finance
 Arkiva - Arhiva - Archive

Mbledhje Ora: 02/04/2024
 Org. Jedin. / Org. Unit: 711-1/2024
 Nr. i Hoqese / Broj iznosa: A-2
 Na. pagese: 24.04.24
 Data / Datum: 24.04.24
 Dofesa: PRISHTINE/A



HYRESE - ULAZNA - INCOMING
 REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
 QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVO
 Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
 Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
 Ministry of Local Government Administration

Data / Datum: 24.04.2024
 Nr. i Lendës: -VI- 020-238/3
 Vlera:

Republika e Kosovës
 Republika Kosova - Republic of Kosovo
 Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Transfera -
 Ministry of Finance, Labour and Transfers

Për:	Sokol Haliti, Kryetar i Komunës së Vitisë Bekim Azizi, Kryesues i Kuvendit të Komunës
Kopje:	Elbert Krasniqi, Ministër në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal Jeton Qela, ud. Sekretare e Përgjithshme, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal Njësia për Administrimin e Dokumenteve, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Përmes:	Avni Zogiani, Zv. Ministër në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve Enis Spahiu, ud. Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
Nga:	Bora Duli, ud. Drejtoreshë e Departamentit Ligjor, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve Data: 16.04.2024
Zyrtarët përgjegjës:	Referencë: 54/2024
1. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Razije Murtezaj, Zyrtare Ligjore, Departamenti Ligjor, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
2. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor	Kimete Zekaj, Zyrtare e Lartë për Politika Buxhetore, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve K. Z.
Lënda:	Kërkesë për rishqyrtimin e ligjshmërisë së aktit të Komunës së Vitisë
Lloji i aktit:	Vendim

I nderuari Kryetar z. Haliti,
I nderuari Kryesues z. Azizi,

Në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021, e në bazë të kompetencave ligjore të Ministrisë, të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren (QRK) Nr. 04/2021, Departamenti Ligjor i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-05 për Vetëqeverisje Lokale, aktin komunal si në vijim:

<i>Vendim 01-110/05308 për financimin e shujtave ditore për shërbyesit civil si dhe stafin teknik dhe mbështetës të komunës së Vitisë Janar - Dhjetor 2024</i>
<i>I miratuar më datë 28.03.2024</i>
<i>I parashtruar për shqyrtim në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal më datë 03.04.2024</i>
<i>I dërguar për shqyrtim në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve më 05.04.2024</i>

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (këtëj e tutje referuar si "Ministria"); pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të mësipërm të Komunës së Vitisë, jep konstatimet ligjore të mëposhtme:

1. Komuna e Vitisë, me anë të këtij akti që është subjekt i shqyrtimit, synon financimin e shujtave ditore për shërbyesit civil si dhe stafin teknik dhe mbështetës të komunës së Vitisë Janar - Dhjetor 2024.
2. Si pikë e parë, dhe për qëllime të këtij vlerësimi është me rëndësi të theksohet se neni 12 i Ligjit 08/L-260 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024 (këtëj e tutje referuar si "Ligji") i precizon limitet në shpenzime për organizatat buxhetore.
3. Për të konkretizuar konstatimin e mësipërm, si dhe tregues i rëndësishëm për të vlerësuar limitet në shpenzime në kuptim të shujtave mbetet neni 12, paragrafi 5 i Ligjit, ku përcaktohet se:

5. Shpenzimi i parave publike nga kategoria e shpenzimeve mallra dhe shërbime nuk është i lejuar për pagesën e punonjësve, qoftë në formë të shtesave apo si kontribute në mall, përfaqshinë këtu shujtat apo dhuratat, duke përjashtuar rimbursimin apo shpenzimet e lejuara për udhëtimet jashtë vendit, sipas legjislacionit përkatës.

4. Nëse elaborohet vlerësimi ligjor krahas frymës së paragrafit 5 të nenit 12 të Ligjit, evidentohet se shpenzimi i parashë publike nga kategoria e shpenzimeve mallra dhe shërbime nuk është i lejuar, qoftë edhe në formë të shujtave, po ashtu edhe në kategorinë e shpenzimeve paga dhe shtesa nuk janë paraparë ndarjet buxhetore për financimin e shujtave për asnjë kategori.

5. Rrjedhimisht, konform interpretimit të kësaj dispozite, Ministria vlerëson se akti i Komunës është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi dhe për pasojë, Komunës së Vitisë i pamundësohet realizimi i masës së përcaktuar në aktin komunal.

Marrë për bazë konstatimet e mësipërme, Ministria kërkon nga Komuna e Vitisë ndërmarrjen e veprimeve konkrete, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të kërkesës për shfuqizim të aktit, në mënyrë që masa e përcaktuar me aktin e komunës të harmonizohet me dispozitat ligjore në fuqi.

Ministria mbetet në dispozicion të Komunës së Vitisë dhe/apo Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me këtë vlerësim.

Me respekt!

Interpretimi i dhënë nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve përkitazi me këtë çështje mbështetet vetëm në këndvështrimet që prekin fushëveprimin legjislativ të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve

PIKA E GJASHTË E RENDIT TË DITËS



REPUBLIKA E KOSOVES • REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISE • OPŠTINA VITINA

Pranuar • Priljevo Merdana 10-05-2024, vitinod			
Nr. i organit Org. broj	Numri/Broj	Shticë Prilog	Vlera Vlerësimet
01-	016/01-		706

24-26 Mars 2024

Manifestimi Tradicional Kulturo-Sportiv “Flakadani i Karadakut 2024”

INFORMATË

DKRS/ Viti



Republika e Kosovës


Republic of Kosova


Komuna e Vitisë

Municipality of Viti/Vitina

Drejtoria për Kulturë, Rinidhe Sport

Department of Culture, Youth and Sports




DATE/A:	Maj, 2024
PËR/ZA/TO:	Komiteti për Politikë dhe Financa, Kuvendi Komunal, Viti
NGA/ZA/FROM:	Z. Valmir Sahiti Drejtor për Kulturë, Rini dhe Sport 
PËRMES/OD/FROM:	Zt. Bekim Azizi Kryesues i Kuvendit Komunal
C.C	Zt. Sokol HALITI Kryetari Komunës së Vitisë
LËNDA:	Informatë për Manifestimin Tradicional “Flakadani i Karadakut 2024 ”

Përmbajtja

I. DKRS – TRUPA KOORDINUESE E MANIFESTIMIT.....	4
a) Ndarja e detyrave të Trupës Kordinuese.....	4
II. RAPORTI NARRATIV I AKTIVITETEVE.....	5-9
a) Aktivite Kulturore dhe Sportive.....	7-9
III. RAPORTI FINANCIAR I MANIFESTIMIT.....	9-10
a) Tabela e kostos totale buxhetore.....	9
b) Tabela krahasuese (2023-2024) e shpenzimeve.....	10
IV. MBËSHTETËSIT E MANIFESTIMIT DHE MEDIAT.....	10

b). Ndarja e detyrave të Trupës koordinuese:



II. RAPORTI NARRATIV I AKTIVITETEVE

a) Aktivitet kulturore dhe sportive

- o Hapja solemne – Dhezja e Flakadanit

Kemi organizuar dhe mbajtur manifestimin tradicional kulturo-sportiv “Flakadani i Karadakut 2024”, si një nga ngjarjet më të mëdha kulturore në Komunën e Vitisë, në të cilin marrin pjesë artistët dhe grupet artistike nga mbarë gjeografia shqiptare dhe më gjere.

Kjo ngjarje kulturore dhe sportive, u mbajt në saje mbështetjes së projektit: “Flakadani i Karadakut 2024”, nga institucionet komunale, me përkujdesjen e Kryetarit të Komunës së Vitisë Z. Sokol Haliti, si dhe organizimit nga ana e Drjetorisë për Kulturë, Rini dhe Sport.

Manifestimi Tradicional Kulturor e Sportiv “Flakadani i Karadakut 2024” ka filluar më 24 mars 2024, ku u bë hapja solemne e manifestimit me dhezjen e Flakadanit dhe ka përfunduar më 26 mars në mbrëmjen finale të festivalit mbarëkombëtar të ansambleve dhe shoqërive kulturore dhe artistike. Në këtë tubim pos udhëheqjes komunale dhe shoqatave të ndryshme prezantuan edhe deputetët e parlamentit të Kosovës si dhe mysafir të shumtë nga Kosova, Shqipëria, Lugina e Preshevës, Maqedonia e Veriut, Bursa e Turqisë dhe Gjermania.

Vlen te permendet qe kete vit pati prurje të reja dhe se manifestimi tradicional Flakadani i Kardakut merr epitetin e një nga ngjarjet më prestigjioze kulturo- sportive në mbarë hapësirat shqiptare dhe më gjere.

Aktivitetet Kulturore dhe sportive:

- Ora e Madhe Letrare – u mbajt në sallën e mbledhjeve të Shtëpisë së kulturës “Gursel dhe Bajram Sylejmani” në Viti, më 26 mars 2024, me fillim në ora 11.00. Në Orën e Madhe Letrare prezantuan shkrimtarë, poetë nga të gjitha trevat shqiptare. E organizuar në koordinim me Shoqatën e Shkrimtarëve “Ramdan Musliu” e cila hapi konkursin letrar, ku me poezitë e tyre kanë konkuruar poetë e shkrimtarë të cilët janë kualifikuar për Orën e Madhe Letrare dhe janë botuar në revistën “Flakdani 2024”.
Juria profesionale në përbërje prej 3 anëtarëve me kryetar Sabit Rrustemi, ka vlerësuar poezitë më të mira të shkrimtarëve konkurrues të Orës së Madhe Letrare- “Flakadani i Karadikut 2024”.
Me çmimin e parë u nderua shkrimtari dhe poetit Nexhat Rexha me poezinë “Fjalë e shkrirë në pagjumësi” nga Kamenica, çmimi i dytë i takoi Farida Ramadanit nga Shkodra, kurse çmimi i tretë u nda për poetin Bilall Maliqi nga Presheva.
Kurse çmimi kryesor “Flakdani i Karadikut” iu nda poetës Shqipe Hasani nga Prishtina me poezinë “Shpirt me ëndrra atdheu”.
- Garat regionale të recituesve – u mbajtën në Sallën e mbledhjeve të Shtëpisë së Kulturës “Gursel dhe Bajram Sylejmani” në Viti, më 25 Mars 2024 me fillim në ora 11.00. Në këto gara prezantuan nxënësit e shkollave të mesme të komunave: Kamenicë, Viti dhe Kaçanik.
Juria profesionale e përbërë nga përfaqësuesit e komunave përkatëse, vlerësuan që vendi i parë t’i takoi Edona Zenelit me poezinë “Mos ma kujto” – SHM “Feriz Guri” nga Kaçaniku kurse vendi i dytë iu nda Bleona Krasniqit, poezia “Një natë pa gjumë” - Gjimnazi “Ismajl Qemajli” – Kamenicë, ndërsa me vendin e tretë u shpërblye Arbësa Misini, SHMP “Jonuz Zejnullahu” nga Vitia.
Për të gjitha shkollat pjesëmarrëse, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport si organizatore e manifestimit , ndau falënderime.
- Festivali Gjithëkombëtar i Shoqërive Kulturore e Artistike – u mbajt nga 24 - 26 Mars – prezantuan 14 -të Shoqëri Kulturore artistike nga Kosova, Shqipëria, Gjermania dhe Presheva, ku hapjen e festivalit e bënë solistët e mirënjohur Mehmet Zuka dhe Ismet Bexheti. Kurse mysafir i mbrëmjes finale të festivalit mbarëkombëtar të ansambleve dhe shoqërive kulturore dhe artistike “Flakdani i Kardakut 2024” , ishte Ansambli Shtetëror i Këngëve dhe Valleve Shqipe “Shota” nga Prishtina.

Mbrëmja e parë e festivalit, më 24 Mars:

Nr.	Ansambl, Grupi artistik, Shoqëria Kulturore	Vendi	Vlerësimi i Jurisë
1.	AKV "KEMAJL AZIZI"	VITI	Jashtë Konkurrencës
2.	SHKA "DRENICA"	SKENDERAJ	✓
3.	SHKA "ZËRI I LUGINËS"	LUGINA E PRESHEVËS	✓
4.	AKV "BAJRAM CURRI"	PRISHTINË	✓

Mbrëmja e dytë e festivalit, më 25 Mars:

Nr.	Ansambl, Grupi artistik, Shoqëria kulturore	Vendi	Vlerësimi i Jurisë
1.	QENDRA KULTURORE "ANAMORAVA"	VITI	Jashtë konkurrencës
2.	SHKA "ZËRI I KAMENICËS"	KAMENICË	
3.	AKV "DEÇANI"	DEÇAN	
4.	SHKA "GRYKA E KAÇANIKUT"	KAÇANIK	✓
5.	GRUPI I KLEJSENHELMIT	GJERMANI	

Mbrëmja e tretë e festivalit, më 26 Mars:

Nr.	Ansambli, Grupi artistik, Shoqëria kulturore	Vendi	Vlerësimi i Jurisë
1.	SHKA "JONUZ RAMADANI"	SMIRE / VITI	<i>Jashtë konkurrencës</i>
2.	AKV "KASTRIOTËT"	FERIZAJ	✓
3.	AKV "ILIRIA"	GJERMANI	✓
4.	AKV "TIRANA"	TIRANË	✓
5.	ASAMBLI SHTETËROR KËNGËVE DHE VALLEVE "SHOTA"	PRISHTINË	<i>Mysafire e festivalit</i>

Juria profesionale në përbërje: Mehmed Xhemajli koreograf, Sami Piraj muzikolog dhe Mustafë Lamallari profesor i muzikës, vlerësuan dhe ndanë 3 vendet e para, çmimin special dhe atë jubilar të Festivalit Gjithëkombëtar të Shoqërive dhe Ansambleve Kulturore Flakadani i Karadakut 2024"

Vendin e parë iu nda AKV "Tirana" nga Tirana, vendi i dytë AKV "Bajram Curri" nga Prishtina dhe vendi i tretë i takoi AKV "Deçani" nga Deçani. Ndërsa me çmimin special u nderua Shoqata "Iliria" nga Gjermania.

- ✓ Më 26 Mars, me fillim nga ora 10.00, u bënë homazhe dhe vendosja e kurorave me lule te varrezat e dëshmorëve – Dëshmorit Nijazi Azemi – Komandant Mjekrra.

Aktivitetet sportive:

- Garat sportive të shahut
- Garat sportive në gjimnastikë
- Garat sportive të basketbollit

Ku të gjitha ndeshjet u zhvilluan gjatë rrjedhës së manifestimit Kulturor dhe Sportiv "Flakadani i Karadakut-2024.

III. RAPORTI FINANCIAR I MANIFESTIMIT

a) Tabela e kostos buxhetore:

Fondi burimor	Lloji i shpenzimit	Kostoja në €
Komuna e Vitisë/DKRS	Akomodimi	1962.00 €
Komuna e Vitisë/DKRS	Zërimi	970.00 €
Komuna e Vitisë/DKRS	Dreka (Shujta për grupet artistike dhe sportive)	8003 €
Komuna e Vitisë/DKRS	Rekuizita sportive (fanella sportive, kupa, diploma, etj)	539.00 €
Komuna e Vitisë/DKRS	Plus TV	2001.00 €
Komuna e Vitisë/DKRS	Ndriçimi profesional, podiumi dhe ekrani led (Skena) për 3 ditë të festivalit gjithëkombëtar "Flakadani i Karadakut 2024"	2361.18 €
Komuna e Vitisë/DKRS	Transporti i grupeve artistike mysafire	€ 220.00
Komuna e Vitisë/DKRS	Shtypja e materialeve grafike katalogë, cerada citillajda, rollo, postera, shtypja në bez e flamujve beza, gravura, fotografi etj.	1635.00 €
Totali:		17,691.18 €

Tabela krahasuese 2023/ 2024

"Flakadani i Karadakut 2023"	Flakadani i Karadakut 2024"
26,557.66 €	17,691.18
	-8866.48

IV. MBËSHTETËSIT E MANIFESTIMIT

Mbështetësit: Komuna e Vitisë-Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport

Mediat: Manifestimi Tradicional kulturor dhe sportive "Flakadani i Karadakut 2024", u mbulua tërësisht nga "Plus Televizion", RTK4, T7, TëVë1, "TV Presheva", Zyra për Informim e Komunës së Vitisë.

Rekomandimet: Manifestimi Kulturo - Sportiv "Flakadani i Karadakut" të vazhdoj si një aktivitet i traditës në Komunën e Vitisë.

Viti, MAJ 2024

Drejtori i DKRS:

/ Valmir Sahiti /



Pika e shtatë" e Rendit të Dites




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPSTINA VITINA

Pranuar - Prillogje M&Dana 13-05-2024 vkt/gsi			
Nr. i organit Org. broj	Numri/Broj	Shtetë Prilog	Vlera Vendime
01-	016/01-		710



Komuna Vitisë
Opstina Vitina
Municipal Vitina

Drejtoria për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural

Nr. 10

Datë: 12.03-29.04.2024

VITI

Informatë për mbjelljet pranverore-2024

Në formë tabelare janë paraqitur të dhënat e aplikuesëve për subvencione sipas kriterëve të MBPZHR- 2024

Nr.	Kultura Lavërtare	Sipërfaqja në hektar	Nr. i fermerëve
	Misër / mbi – 1/ha	2045.30 /ha	652
	Elb/mbi-1/ha	3.94/ha	2
	Thekër/mbi 1/ha	3.52/ha	2
	Gjithësej	2,052.76/ha	
	Bimë Industriale		
	Lulediell	41.84/ha	2
	Bimë mjekuese aromatike	3.99/ha	2
	Perim-kulturë- mbi 0,30/ha		
	Patate	84.92/ha	72
	Shalqin	58.02/ha	45
	Pjepër	9.09/ha	18

	Lakër	14.39/ha	19
	Kungull	44.24/ha	48
	Spec	5.62/ha	7
	Fasule	132.18/ha	69
	Kunguj misiri	19.92/ha	22
	Qepë	7.74/ha	10
	Tranguj	0.20/ha	1
	Gjithësej perime në fushë të hapur	381.32/ha	
	Perime në serra	5.02/ha	12

Drejtori i Bujqësisë

Naim Pira

për [Signature]

